



Raporti Vjetor 2011

**Faqe 4**

Çalik Holding është i pranishëm në 15 shtete në sektorët e energjisë, telekomit, tekstit, ndërtimit, financës, medias dhe minierave.

**Faqe 16**

BKT është përmendur shpesh nga revista dhe organizata prestigjioze të industrisë bankare si banka më e mirë në Shqipëri.

**Faqe 18**

BKT Kosova boton rezultate të suksesshme në përfundim të katërvjeçarit të plotë të punës së saj.

**Faqe 20**

Një ndër shërbimet më të rëndësishme dhe më novatore të prezantuara nga BKT në Shqipëri është sistemi gjithëpërfshirës i pagimit të faturave.

**Faqe 22**

BKT u bë banka e parë shqiptare që shtriu kreditimin ndërkombëtarisht, duke dëshmuar dhe një herë se është një bankë unike dhe lider në treg.

**Faqe 24**

BKT është e angazhuar të kuptojë nevojat e klientëve të saj dhe të ofrojë zgjidhje specifike që i mbështesin ata të arrijnë objektivat e tyre të biznesit.

**Faqe 26**

Pozicionimi i rëndësishëm i BKT-së në financimin e tregtisë së jashtme ka ushqyer më tej rritjen e bankës në këtë zë biznesi në vitin 2011.

**Faqe 28**

Një strukturë organizative dinamike dhe fleksibël i lejon BKT-së të përshtatet me kërkesat e kohës dhe ndihmon në përmirësimin e shpejtësisë dhe të cilësisë së shërbimit.

**Faqe 30**

Për të ndihmuar Somalinë, BKT mori pjesë në një fushatë ndihme që u organizua bashkërisht nga Gjysmëhëna e Kuqe Turke, gazeta "Sabah", dhe TİKA.

Përmbajtja

- | | | | | | |
|----|--|----|--------------------------------------|----|-------------------------------------|
| 2 | BKT në shifra | 21 | Vlerësim i Aktiviteteve të 2011-s | 33 | Planet për 2012-n |
| 4 | Grupi Çalik | 21 | Bankingu Individual | 34 | Raporti i Auditorëve të Pavarur |
| 6 | Momente të rëndësishme | 23 | Bankingu Tregtar | | Pasqyrat Financiare të Konsoliduara |
| 8 | Bordi Drejtues | 25 | Bankingu i Korporatave | | |
| 10 | Menaxhimi i Lartë | 27 | Thesari dhe Institucionet Financiare | | |
| 12 | Mesazhi i Kryetarit të Bordit Drejtues | 27 | Grupi i Menaxhimit të Riskut | | |
| 14 | Mesazhi i Drejtorit të Përgjithshëm | 29 | Burimet Njerëzore | | |
| 16 | Çmimet dhe Vlerësimet në Vitin 2011 | 31 | Përgjegjshmëria Sociale e Korporatës | | |
| 18 | Dega e Kosovës | | | | |
| 19 | BKT-Kosova në Shifra | | | | |

Tradicionale, por novatore...

Historia e Bankës Kombëtare Tregtare (BKT) fillon më 30 nëntor 1925, ditë kur u inaugurua selia e saj në Durrës.

Pas shumë dekadash, të cilat ishin dëshmitare të ndryshimeve të regjimit dhe të një lufte botërore, dy pjesët përbërëse të bankës, Banka Tregtare Shqiptare dhe Banka Kombëtare e Shqipërisë, u bashkuan në vitin 1993 dhe banka mori emrin që ka aktualisht. BKT është regjistruar si shoqëri aksionare në vitin 1997 dhe u privatizua në vitin 2000.

Si ofrues pionier i shërbimeve financiare në industrinë bankare shqiptare, BKT kombinon eksperiencën e saj të thelluar dhe kulturën e biznesit me qasjen novatore në mënyrë që të plotësojë nevojat financiare të klientelës së saj.

Duke operuar nëpërmjet një rrjeti prej 80 degësh (57 në Shqipëri dhe 23 në Kosovë), BKT është e pranishme gjerësisht në vend, duke qenë banka më e madhe shqiptare në rajon.



Në vitin 2011, BKT festoi 85 vjetorin e hapjes së degës së saj të Vlorës. Pjesa e jashtme e ndërtesës së bankës, e cila është një pikë dalluese në Vlorë, u rinovua me rastin e hapjes së degës, ndërkohë që projektimi i brendshëm i degës u bë në mënyrë që të dilnin më mirë në pah karakteristikat e ndërtesës dhe të ofrohej një mjedis modern shërbimesh për klientët tanë.

BKT në shifra

Aspektet kryesore financiare

(në mijë dollarë amerikanë - USD)	2009	2010	2011	Ndryshimi % (2010-2011)
Totali i Aktivit	1,340,042	1,502,902	1,864,689	24
Hua dhe Paradhënie për Klientët	494,271	551,046	778,063	41
Depozitat e Klientëve	1,167,147	1,309,652	1,581,303	21
Kapitali i Paguar	78,299	84,622	100,000	18
Totali i Kapitalit Aksioner	94,671	118,670	138,165	16
Fitimi Neto	13,044	25,003	29,415	18

Treguesit kryesorë

Treguesit e Performancës (%)	2009	2010	2011
Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit	13.2	13.1	12.9
Kthimi nga aktivet mesatare (ROAA)	1.1	1.8	1.1
Kthimi nga kapitali (ROE)	12.9	25.4	16.4
Kreditë me probleme/portofoli bruto i kredive (PAR 90)	5.1	8.4	5.6

Struktura Aksionere


Çalık Finansal Hizmetler, filial i Çalık Holding të Turqisë u bë pronari i vetëm dhe i plotë i BKT-së në vitin 2009.

Struktura aksionere deri më 31 dhjetor 2011	Numri i aksioneve	Totali në USD	%
Çalık Finansal Hizmetler A.Ş.	8,097,166	100,000,000	100

Totali i Aktivit

USD 1,865 milionë


Në vitin 2011, totali i aktivitet të BKT-së u rrit me 24% dhe arriti në shifrën 1,865 milionë dollarë.



Huatë

USD 778 milionë


Duke arritur një rritje prej 41% në vitin 2011, totali i huave të BKT-së arriti në 778 milionë dollarë.



Fitimi neto

USD 29 milionë


BKT realizoi gjatë vitit 2011 një fitim neto prej 29 milionë dollarë, duke shënuar një rritje prej 16% mbi shifrën e vitit 2010.



Përqindja e depozitave në treg

18.4%


Si rezultat i strategjive të saj të suksesshme, përqindja e depozitave të BKT-së në treg arriti në 18.4%.



Përqindja e Tregut për Totalin e Huave (duke përfshirë Kosovën)

14.8%


Përqindja e tregut të BKT-së totalin e huave u rrit në 14.8%.



Numri i Degëve (duke përfshirë Kosovën)

80

Me shtimin e tetë degëve të reja, rrjeti i BKT-së u shtri në 80 degë deri në fund të vitit 2011.





Themelimi i Çalık Holding u bë nga Z. Ahmet Çalık në vitin 1981, i cili ishte pjesëtar i familjes Çalık, aktivitetet tregtare të së cilës i kanë filluar që në vitet '30. Sot, Grupi ka të punësuar mbi 20,000 punonjës nëpërmjet sipërmarrjeve të tij të biznesit në 15 shtete në sektorët e energjisë, telekomit, tekstileve, ndërtimit, financës, medias dhe minierave.

Çalık Holding, që është aktiv në një rajon që shtrihet nga Azia Qendrore deri në Lindjen e Mesme, ka një xhiro prej më shumë se 3 miliardë dollarësh amerikanë në vit. Aktivitetet e konsoliduara të Grupit e tejkalojnë shifrën prej 6.5 miliardë dollarësh dhe aktualisht Grupi po punon për një portofol projekti me vlerë 20 miliardë dollarë.

Si rezultat i pjesëmarrjes së tij aktive në tenderët e brendshëm dhe jashtë shteti, Grupi Çalık ka blerë Albtelecom-in, operatorin e telefonisë fikse dhe furnizuesin e internetit të Shqipërisë në vitin 2007, Grupin Mediatik Turkuvas, që është një ndër dy ndërmarrjet më të mëdha mediatike në Turqi në vitin 2008, dhe Yeşilirmak Electricity Distribution Inc. (YEDAŞ), e cila është kompania përgjegjëse për shpërndarjen e energjisë elektrike në pesë qytetet kryesore të Turqisë në vitin 2010.

Fillimisht duke synuar të krijonte një vlerë të shtuar dhe investime në përfitim të njerëzve në çdo vend ku ushtron aktivitetin e tij, menjëherë pas përfundimit të Projektit Spitalor për Sytë me kapacitet prej 120 shtretërisht në Turkmenistan, Çalık Holding ka filluar të ndërtojë dy impiante për prodhimin e energjisë elektrike, me kapacitete të përgjithshëm prej 2,000 MW në Irak, transmetimet në dy kanale të reja tematike A Haber (A News) dhe Minika si dhe kohët e fundit ka nisur një Projekt për Solucionin e Serumit me kapacitet prej 10 milionë shishesh dhe Projekte Spitalore Dentare të gatshme.

Çalık Holding është bërë një ndër investitorët kryesorë turq në Azinë Qendrore dhe në Ballkan, si dhe një ndër punëdhënësit më të mëdhenj në Turqi.

Çalık Holding është bërë një ndër investitorët kryesorë turq në Azinë Qendrore dhe në Ballkan, si dhe është një ndër punëdhënësit kryesorë në Turqi. Çalık Holding ka krijuar bashkëpunime ndërkombëtare me shumë kompani globale dhe prestigjioze, të tilla si Rosneft, Initec Energia, Eni, Mitsubishi, EBRD, EWE, General Electric, Alacer Gold, Qatar Holding dhe Türk Telekom.

Çalık Holding ka ndërmarrë dy projekte energjetikë, të cilat konsiderohen si dy ndërhyrje të rëndësishme në nivelin global që janë përkatësisht Projekti i Tubacioneve të Naftës së Papërpunuar Turqi - Samsun-Adana/Ceyhan, dhe Projekti i Rafinerisë së Naftës Adana (Ceyhan), i cili përbën projektin e parë të rafinerisë ambientaliste në zemër të Mesdheut Lindor. Grupi ka nënshkruar marrëveshje me Alacer Gold, partneri i Çalık Holding në minierën e floririt Çöpler në İliç, Erzincan, për 16 prona të gjendura në qytete të ndryshme të Turqisë. Grupi zotëron 50% të tre kompanive të krijuara për këtë qëllim. Prodhimin e përgjithshëm të floririt në minierën aktuale të floririt në Erzincan e ka tejkaluar masën prej 185 mijë ons në vitin 2011.


Çalık Holding, i njohur për reputacionin dhe përgjegjshmërinë e tij në sektorët ku ushtron aktivitetin, me strukturën e tij të fuqishme financiare, ka formësuar planet e biznesit, strategjitë dhe objektivat e tij mbi bazën e qëndrueshmërisë. Çalık Holding ka një strukturë novatore biznesi që e bën atë lider të rëndësishëm në këtë fushë. Në kuadrin e strategjive në rritje e të provuara, Çalık Holding ka filluar projekte të mëdha dhe ka kryer investime me vlerë të shtuar në vendet ku shtrin aktivitetin e tij. Grupi kombinon në mënyrën më të mirë të mundshme cilësitë sipërmarrëse dhe produktive të kulturës së tij të pasur të biznesit për të mbetur ndërmjet aktorëve më të rëndësishëm dhe të pranishëm në fushat kryesore të biznesit.



Përmasa e aktiveve të konsoliduara të Grupit, i cili kryesohet nga Ahmet Çalık, e tejkalon nivelin e 6.5 miliardë dollarëve; Grupi po punon aktualisht për një portofol projekti me vlerë prej mbi 20 miliardë dollarësh.

Momente të rëndësishme

BKT, e cila festoi së fundmi 86 vjetorin e saj, është banka e dytë më e madhe, banka tregtare më e vjetër në Shqipëri dhe banka më e madhe shqiptare në rajon.



2006

60% e aksioneve të BKT-së iu transferuan Çalik-Şeker Konsorsiyum Yatırım A.Ş.

BKT mori çmimin "Banka më e Mirë e Vitit" nga revista "The Banker".

2007

BKT hap një degë të re në Prishtinë, Kosovë, në nëntor të vitit 2007, duke realizuar kështu investimin e parë të huaj të saj.

2009

BKT u bë 100% degë e Grupit Çalik pas blerjes së pjesës së mbetur të aksioneve nga Çalik Finansal Hizmetler.

BKT u vlerësua si "Banka më e Mirë në Evropën Juglindore për vitin 2009".

2010

BKT festoi 10 vjetorin e privatizimit të saj.

BKT festoi 85 vjetorin e hapjes së Degës Durrës.

BKT mori çmimin "Banka më e Mirë e Vitit në Shqipëri" nga revista "The Banker".

2011

BKT bëhet banka e parë shqiptare që e shtrin kreditimin e saj në nivel ndërkombëtar.

BKT cilësohet nga The Banker si "Banka e Vitit" për Shqipërinë.

EMEA Finance e cilëson po ashtu BKT-në si "Banka më e Mirë në Shqipëri për vitin 2010".

BKT-ja nënshkruan një marrëveshje financimi me Korporatën Islamike Tregtare dhe Financiare (ITFC). Sipas kësaj marrëveshje, grupi kryen transaksionin e parë murabaha në Shqipëri.



Strategjitë e përcaktuara mirë dhe qasja aktive e BKT-së dëshmohen nga rezultatet e arritura në vitin 2011.



Mehmet Usta
Kryetar i Bordit Drejtues



Mehmet Ertuğrul Gürler
Zëvendës Kryetar i Bordit Drejtues



Seyhan Pencablıgil
Drejtor i Përgjithshëm dhe
Anëtar i Bordit Drejtues



İzzet Serhat Demir
Anëtar i Bordit Drejtues



İsmail Hakkı Ergener
Anëtar i Bordit Drejtues



Angazhimi, dedikimi, puna e madhe dhe inteligjenca e skuadrës drejtuese profesionale kanë kontribuar fort për arritjen e rezultateve të vitit 2011.



Seyhan Pencablil
Drejtor i Përgjithshëm dhe
Anëtar i Bordit Drejtues



Suat Albayrak
BKT Kosova
Drejtor



Abdurrahman Balkız
Drejtor i Grupit të
Operacioneve



Cüneyt Erigüç
Drejtor i Grupit të
Bankingut Individual



Pekhan İşipek
Drejtor i Grupit të Bankingut
Tregtar



Aydın Argın
Drejtor i Grupit të
Bankingut të Korporatave



Kaan Pekin
Drejtor i Grupit të Thesarit
dhe Institucioneve
Financiare



Skënder Emni
Drejtor i Grupit të Financës
dhe TI



Ndue Maluta
Drejtor i Grupit të
Menaxhimit të Riskut



Natasha Ahmetaj
Drejtoresh e Divizionit të
Rrjetit



İbrahim Yaşar
Drejtor i Grupit të Auditit
të Brendshëm



Hysen Çela
Kryetar i Komitetit të
Auditit



Si reputacioni ynë si banka e “të parëve” në Shqipëri ashtu dhe sukseset praktike që kemi arritur në këtë drejtim janë reflektuar në shifrat e klientëve dhe në pjesët e tregut që zotërojmë.

Pas botimit të rezultateve që e çojnë rritjen dhe performancën e fitimit në nivele të reja, BKT shënoi përvjetorin e saj të 86 të aktivitetit në vitin 2011. Në fund të vitit të tretë të krizës ekonomike globale që vazhdon ende, sektori publik, i cili ka qenë burim shpëtimi në të shkuarën, tani konsiderohet si aktori kryesor në krizë. Në veçanti, kjo situatë përbën realitet në Europë. Në një mjedis ku koncepti i "rrezikut të vendit" ka marrë një rëndësi të re dhe madje dhe më të madhe, Shqipëria ka dëshmuar një pozicionim të fortë, ndërkohë që banka jonë ka qenë protagonistja e një performance që nuk mund të kalohet pa vënë re, duke përdorur dinamikën e saj për të marrë avantazhet më të mira të mundshme nga kushtet aktuale.

Staturës së saj si banka me rrënjët më të thella dhe si banka e dytë më e madhe në Shqipëri, BKT i shton një plus të rëndësishëm si "bankë novatore që e përdor teknologjinë në mënyrën më efektive të mundshme". Me mbështetjen e aksionerit kryesor, Grupit Çalik, ne po angazhohemi në investime të rëndësishme në industrinë bankare. Si reputacioni ynë si banka "e të parëve" në Shqipëri ashtu dhe sukseset praktike që kemi arritur reflektohen në shifrat e klientëve dhe në pjesët e tregut që zotërojmë. Në Shqipëri aktualisht ushtrojnë aktivitetin e tyre gjashtëmbëdhjetë banka të zotëruara nga grupet e shërbimeve financiare ndërkombëtare. Zotërimi i prej më shumë se 18% të tregut të aktiveve nga BKT përfaqëson përqindjen më të lartë të arritur nga ndonjë bankë turke që është aktualisht aktive në arenën ndërkombëtare.

BKT është cituar nga The Banker si "Banka e Vitit" për Shqipërinë në vitin 2011. Kjo është hera e dytë në dy vite të njëpasnjëshme dhe hera e tretë që prej krijimit të saj që Bankës tonë i është dhënë ky çmim. Po ashtu, EMEA Finance e ka cilësuar BKT-në si "Banka më e Mirë për 2010-n në Shqipëri".

Pavarësisht paqëndrueshmërive në klimën ekonomike europiane, ne kemi vijuar me forcimin e rrjetit tonë të degëve, ndërkohë që kemi rikonstruktuar dhe degët tona ekzistuese. Duke ushtruar aktivitetin nëpërmjet një rrjeti prej 80 degësh (57 në Shqipëri dhe 23 në Kosovë), BKT zotëron një prani të gjerë shtrirje në të gjithë vendin, gjë që e bën atë bankën më të madhe shqiptare në rajon.

Banka jonë ka formuluar dhe është pjesë e një politike burimesh njerëzore që kërkon të forcojë më tej kapitalin intelektual dhe që bazohet në parimet e forcimit të ndjenjës

së besnikërisë ndaj kompanisë, frymës së të punuarit në grup dhe inkurajimit të vlerave të qëndrueshme që mund të ndahen nga i gjithë personeli. Ndershmëria, vigjilenca, dhe kreativiteti janë cilësitë themelore të punonjësve tanë dhe forca shtytëse e BKT-së për të ardhmen.


Në të njëjtin kuadër, ne vijuar të bashkëpunojmë me Universitetin "Aleksandër Moisiu" të Durrësit për projektin FASTIP duke ofruar bursa studimi për disa nga pjesëmarrësit në program dhe duke i ofruar vende pune në bankë të diplomuarve nga programi. Të 15 të diplomuarit e parë të këtij projekti u bënë pjesë e BKT-së në vitin 2011.

Sinergjitë brenda grupit përbëjnë një tjetër çështje të cilës ne i japim përparësi. Në këtë kuadër, ne prezantuar një shërbim të ri dhe unik në vitin 2011, i cili u bën të mundur përdoruesve të telefonisë celulare të kryejnë rimbushje nëpërmjet njësive POS si dhe nga Dega Internet e BKT-së. Ky shërbim ofrohet në bashkëpunim me Eagle Mobile, e cila është një tjetër kompani e Grupit.

Aksioneri kryesor Grupi Çalik ka punësuar më shumë se 20,000 njerëz në 15 shtete dhe e kryen pjesën më të madhe të aktivitetit të tij në nivelin ndërkombëtar. Pas përpilimit dhe zbatimit të strategjisë së grupit që synon angazhim në sektorin bankar nëpër një rajon gjeografik të përcaktuar si të afërt, i cili përfshin Ballkanin, ne si BKT kemi filluar studimet e fizibilitetit për të shtuar Maqedoninë si objekt të aktiviteteve tona.

Ne kemi besim të madh në të ardhmen e vendit tonë dhe në të ardhmen e rajonit dhe, sigurisht, kemi shumë besim dhe në të ardhmen e BKT-së. Ne po rritemi; ne po investojmë në teknologji të reja, në burimet tona njerëzore; ne po vazhdojmë t'ia bëjmë më të lehtë jetën klientëve tanë me prezantimin e produkteve dhe shërbimeve të reja financiare.

Në përmbyllje, më lejoni të shpreh falënderimet e mia më të sinqerta të gjithë drejtuesve dhe stafit, klientëve, partnerëve të biznesit dhe institucioneve financiare për kontributet e tyre për rezultatet e suksesshme të Bankës për vitin 2011.



Mehmet Usta
Kryetar i Bordit Drejtues



2011-a ka qenë një ndër vitet e BKT-së ku janë arritur ose janë tejkaluar të gjitha objektivat e rritjes. Ndërkohë që hendeku ndërmjet BKT-së dhe pasuesve të saj po thellohet, ne po i afrohem më pranë pozicionimit si banka numër një.

2011-a ka qenë një ndër vitet e BKT-së ku janë arritur ose janë tejkaluar të gjitha objektivat e rritjes. Si rezultat, pjesa jonë e tregut është rritur në të gjitha segmentet e biznesit, duke na bërë bankën e dytë më të madhe jo vetëm në aktive dhe depozita, por, për herë të parë dhe bankën e dytë më të madhe dhe për huatë. Ndërkohë që diferenca ndërmjet BKT-së dhe pasuesve të saj po zgjerohet, ne po i afrohem më pranë pozicionit si banka numër një.

Rritja ka qenë e rregullt dhe e kontrolluar, ashtu siç është dëshmuar nga audite/ekzaminime të ndryshme të kryera mbi bankën në vitin 2011: BKT iu nënshtroi një auditit tatimor, të kryer në fillim të vitit 2011, që përfshinte një periudhë tre-vjeçare 2007-2009, dhe që e nxori bankën të pastër. Po ashtu, Banka rezultoi e pastër pas inspektimit nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave në maj të vitit 2011. Ekzaminimi nga Banka e Shqipërisë nuk identifikoi asnjë problem serioz dhe konfirmoi vlerësimin më të lartë CAMELS të bankës në Shqipëri. Vlerësime të tilla të larta u konfirmuan dhe në vitin 2011 nga JCR-Eurasia dhe nga Moody's. Së fundmi dhe çfarë është më e rëndësishmja, BKT u inspektua në qershor të vitit 2011 nga një skuadër e përbashkët përfaqësuesish nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Banka e Shqipërisë. Inspektimi rezultoi në konfirmimin e përputhshmërisë së plotë të bankës me legjisllacionin në fuqi. Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave shprehu më tej vlerësimin e saj nëpërmjet një letre për përputhshmërinë ekzemplare të BKT-së me kërkesat e legjisllacionit dhe të praktikës shqiptare të AML-së.

Në vitin 2011 aktivet gjithsej u rritën me 28 përqind në terma realë dhe ishin pak mbi rritjen e planifikuar prej nesh prej 27 përqind. Ne e mbyllëm vitin me 1.9 miliardë dollarë në bilanc, nga të cilat 1.6 miliardë dollarë janë depozita (të cilat janë rritur deri më 24 përqind) dhe 0.8 miliardë dollarë janë hua (të cilat janë rritur deri me 45 përqind). Kthimi mbi kapitalin është 16.4 përqind, ndërsa kthimi mbi kapitalin i axhustuar duke marrë parasysh zërat e pazakontë është 25.9 përqind.

Ndërsa kemi arritur objektivat tona, kemi prezantuar po ashtu produkte dhe shërbime të reja dhe kemi ndërmarrë iniciativa për herë të parë. BKT ka ndërmarrë transaksionin e parë murabaha të realizuar në Shqipëri, ndërkohë që jemi në negociata me vendet e Rajonit të Gjirit për një marrëveshje të mundshme sukuk. Banka organizoi një seminar për praktikën financiare tregtare për klientët tanë (potencialë) dhe po drejtojmë një grup kompanish/shoqatash për të krijuar Komitetin Kombëtar të Dhomës së Tregtisë për Shqipërinë për ta bërë vendin anëtar të ICC-së.

Në vitin 2012, ne planifikojmë një rritje të bilancit prej 25 përqind, pasi depozitat do të rriten me 26 përqind për të arritur në nivelin e 2 miliardë dollarëve. Rritja në hua është më pak agresive (dhe kryesisht në monedhë vendase) në nivelin prej 20 përqind, me më shumë fokus tek individët. Ne planifikojmë një fitim neto prej 40 milionë dollarësh, të cilat korrespondojnë me një normë kthimi të kapitalit prej 30 përqind dhe rritjen e kapitalit aksioner në nivelin e 179 milionë dollarëve.

Ajo çfarë kemi bërë dhe ajo çfarë planifikojmë të bëjmë nuk do të ishte e mundur po të mos kishim stafin e dedikuar të Bankës dhe mbështetjen dhe udhëheqjen profesionale të Bordit Drejtues, të cilëve u jam mirënjohës.

Me respekt,



Seyhan Pencablıgil

Drejtor i Përgjithshëm dhe Anëtar i Bordit Drejtues



BKT është përmendur vazhdimisht nga revistat dhe organizatat prestigjioze të industrisë bankare, të cilat e kanë vlerësuar atë si banka më e mirë në Shqipëri.

Çmimet

BKT është përmendur vazhdimisht nga revistat dhe organizatat prestigjioze të industrisë bankare, të cilat e kanë vlerësuar atë si banka më e mirë në Shqipëri.

Në vitin 2011

- BKT vlerësohet nga The Banker si "Banka e Vitit" për Shqipërinë për vitin 2011. Ky ishte viti i dytë i njëpasnjëshëm dhe viti i tretë gjithsej i marrjes së këtij çmimi nga BKT.
- EMEA Finance e cilëson po ashtu BKT-në si "Banka më e Mirë në Shqipëri për vitin 2010".
- BKT merr nga Deutsche Bank "Çmimin e Ekselencës për Vitin 2010 për Cilësinë e Transferimit të Pagesave" ("2010 Straight-Through-Processing (STP) Excellence Award").



Ceremonia e dhënies së çmimit u organizua në Londër më 30 nëntor 2011. Çmimi u mor nga Z. Mehmet Usta, Kryetar i Bordit Drejtues të BKT-së, Z. Seyhan Pencablıgil, Drejtori i përgjithshëm dhe Anëtar i Bordit Drejtues dhe Z. Kaan Pekin, Drejtor i Grupit të Thesarit dhe i Institucioneve Financiare.

Vlerësimet

Duke iu referuar fitimit dhe rritjes së qëndrueshme të Bankës, agjenci të njohura ndërkombëtare e rikonfirmuan pozicionin e BKT-së si banka më e besueshme dhe financiarisht më e fuqishme në Shqipëri.

Në prill të vitit 2011, BKT mori konfirmimin e të qenit e vetmja bankë që mori "AAA(Alb)" për të tretin vit radhazi për vlerësimin e zhvillimit të qëndrueshëm nga JCR-Eurasia Rating, e cila është filial i agjencisë prestigjioze japoneze për Vlerësimin e Kredive.

Në nëntor të vitit 2011, Moody's e konfirmoi BKT-në në vlerësimin "B1". Ky vlerësim është vlerësimi më i lartë që mund të japë Moody's për një subjekt shqiptar.

Dega e Kosovës

E licencuar në vitin 2007, BKT Kosovë ka arritur rezultate të suksesshme me përfundimin e vitit të saj të katërt të plotë të funksionimit.

Duke ndjekur një strategji unike, BKT Kosovë ia doli mbanë në krijimin e një vlere më të madhe për klientët duke ofruar një gamë të gjerë produktesh dhe shërbimesh të dallueshme. Pavarësisht që është banka më e re në shtetin më të ri në Europë, kjo bankë është bërë një ndër institucionet financiare më të spikatura në Kosovë. Në vetëm pak vjet, BKT Kosovë e ka pozicionuar veten ndërmjet liderëve të industrisë bankare në vend.

Banka ofron një gamë të gjerë shërbimesh me cilësi të lartë për subjekte shtetërore dhe private si dhe për individët.

Në vitin 2011, BKT Kosovë realizoi 138 milionë euro në totalin e aktiveve, duke shënuar kështu një rritje vjetore prej 51%. Totali i huave u rrit me 64% dhe arriti në shifrën e 111 milionë eurove. Depozitat janë burimi kryesor i financimit të BKT-së Kosovë. Në vitin 2011 depozitat u rritën me 130% duke arritur në 100 milionë euro. Fitimi neto i BKT-së Kosovë në fund të vitit 2011 ishte 1.5 milionë euro.

Rritja e degëve në 23 gjatë vitit 2011 u shoqërua nga një rritje e madhe në zotërimin e pjesës së tregut si për huamarrjen dhe për depozitat, duke e bërë Bankën lider përsa i përket gamës së produktit financiar, teknologjive të reja, strategjive novatore dhe vlerësimeve. Pozicionimi efektiv i degës ka krijuar dhe një perceptim të gjerë ndërmjet konsumatorëve që dega e BKT-së Kosovë është banka më e mirë në treg përsa i përket shërbimit të konsumatorëve, huave personale, kredive hipotekore, kartave të kreditit dhe financimit të pagesave për shkollim.



Banka ofron një gamë të pasur shërbimesh me cilësi të lartë për subjektet shtetërore dhe private si dhe për individët.

BKT njihet në treg për arritjet e saj në produktet novatore, njerëzit ekzemplarë, iniciativat e qëndrueshme dhe kontributet e barmirësisë për shoqërinë. Banka është e vendosur të forcojë më tej identitetin e saj nëpërmjet praktikave të shëndetshme të biznesit, përgjegjësisë sociale dhe qeverisjes së fortë të biznesit, ndërsa ruan reputacionin e saj si lider në prezantimin e produkteve të reja dhe dallimit të saj përmes niveleve të larta të kënaqjes së klientëve.

Rritja e BKT Kosovës në të ardhmen bazohet në strategjitë bazë që do t'i lejojnë bankës të bëhet ofruesi numër një i shërbimeve bankare në Kosovë, të vazhdojë rritjen e përqindjes së saj në treg, të ruajë pozicionin drejtues në Kërkim dhe Zhvillim dhe, ajo çfarë është më e rëndësishmja nga të gjitha, të rrisë fuqinë e fitimit solid të Grupit.

BKT-ja e Kosovës numëronte 254 të punësuar në borderonë e saj në fund të vitit 2011.




Pavarësisht se është banka më e re në shtetin më të ri në Europë, BKT është bërë një ndër institucionet më të spikatura financiare të Kosovës.

BKT-Kosova në shifra


Totali i Aktiveve € 138 milionë

Në vitin 2011, totali i aktiveve të BKT-së Kosovë u rrit me 51% dhe arriti në shifrën 138 milionë euro.




Totali i Huave € 111 milionë

Totali i huave të BKT-së Kosovë realizoi një rritje të madhe prej 64% në vitin 2011.



Totali i Depozitave € 100 milionë


Me një performancë të jashtëzakonshme në vitin 2011, totali i depozitave të BKT-së Kosovë u rrit me 130%.



Pjesa e Tregut sipas Totalit të Aktiveve

5.5%


BKT Kosovë ka arritur një pjesë të tregut prej 5.5% përsa i përket aktiveve.



Fitimi neto

€ 1.5 milionë


Në vitin 2011, BKT Kosovë ka regjistruar një fitim neto prej 1.5 milionë euro.



Numri i degëve

23

Numri i përgjithshëm i degëve u rrit në 23; për vitin 2011 u hapën 8 degë të reja.



dega "Internet"



Një ndër shërbimet më të rëndësishme novatore dhe pioniere të prezantuara nga BKT në Shqipëri ishte sistemi gjithëpërfshirës i pagimit të faturave, i cili u mirëprit nga të gjitha ndërmarrjet kryesore të shërbimeve në vend.

Vlerësimi i aktiviteteve të vitit 2011

Bankingu Individual

Rritja në huadhënien për individët vazhdon.

Vlera e përgjithshme e portofolit të kredive të Bankës për individët ka arritur në 229 milionë dollarë. Në huatë për individët, pjesa e tregut të Bankës ishte më e madhe se 16%, shifër e cila përfaqëson thujt një rritje me tre pikë përqindje.

Prima Card është programi i parë në Shqipëri i kartës së kreditit bazuar në këste.

E pajisur me teknologjinë e fundit Chip & Pin, karta Prima e BKT-së u ofron përdoruesve opsione këstesh dy deri në dymbëdhjetë mujore.

Gjatë vitit 2011, BKT realizoi disa fushata të synuara për inkurajimin e përdorimit të kartave të kreditit. Nëpërmjet këtyre fushatave, Banka i njohu klientët shqiptarë me novacione të tilla si interesi zero, mundësi blerje me këste të lidhura me festa të njohura, të tilla si Dita e Nënës, Dita e Shën Valentinit, Dita e Vitit të Ri, etj.

Numri dhe volumi i transaksioneve në POS të tregtarëve partnerëve janë në rritje.

Në kërkim të rritjes së produktivitetit në operacionet me tregtarët partnerë, Banka i ka kushtuar vëmendje të veçantë marketimit të POS-it në vitin 2011. Numri i POS-eve në përdorim arriti në 2,171. Numri total i transaksioneve në POS është rritur me më shumë sesa pesë herë.



ATM-të e BKT-së shërbejnë si Zyra Këmbimi Valutor duke pasur funksione të shumta.

Prima Card- programi i parë i kartave të kreditit me këste i prezantuar në Shqipëri.

BKT është lider i pasfidueshëm në pagesat e faturave të shërbimeve.

Gjatë vitit 2011 një ndër shërbimet më të rëndësishme dhe më novatore të prezantuara nga BKT në Shqipëri është sistemi gjithëpërfshirës i pagimit të faturave, të cilin e kanë përqafuar të gjitha kompanitë më të mëdha të shërbimeve në Shqipëri, të tilla si kompania e telefonisë fikse ALBtelecom, operatorët e telefonisë celulare, të tillë si Eagle Mobile, Vodafone, AMC, Plus, ofruesi i energjisë elektrike CEZ Shpërndarje, ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve dhe subjekte të tjera.

Zhvillimet vijnë dhe në rrugët e alternative të shpërndarjes.

Sipërmarrja e ofritit të shërbimeve online që nisi në 2010-n vazhdon të rritet duke regjistruar aplikime të reja. Gjatë të njëjtës periudhe, numri i përgjithshëm i transaksioneve u rrit me 2.5 herë.

Në vitin 2011 BKT shtoi pagimin e faturave të Eagle Mobile dhe të abonentëve të televizioneve dixhitale me pagesë në listën e saj të funksioneve që realizohen online. Kjo është hera e parë që shërbime të tilla online u vihen në dispozicion klientëve në Shqipëri.

Gjatë vitit 2011, BKT ka kryer disa fushata për nxitjen e produkteve bankare për individët.



BKT u bë banka e parë shqiptare që e ka shtrirë kreditimin në nivel ndërkombëtar dhe ka dëshmuar dhe një herë se është bankë unike dhe lider në sektor.

Foto: Drejtori i Grupit të Bankingut të Korporatave Aydın Argın duke vizituar një minierë në Afrikën e Jugut, një projekt në të cilin BKT është përfshirë në formën e një kredie prej 20 milionë dollarë.

Shërbimi bankar për bizneset

Rritja e qëndrueshme e huave vazhdon.

Grupi i Bankingut të Korporatave i ka tejkaluar objektivat e tij për rritje në vitin 2011.

Huatë në mjete financiare, quajtur ndryshe huatë në cash, në linjën e biznesit të shërbimit bankar për biznesin u rritën me 60.15% nga 203 milionë euro në vitin 2010 në 326 milionë euro në vitin 2011. Ndërkohë që huadhënia për klientët në Shqipëri dhe në Kosovë u rrit me 46.6% vitin e shkuar, rritja e huadhënies ndërkombëtare ishte dhe më domethënëse, duke arritur nivelin e 86.5%.

Totali i huave në të gjitha kategoritë (në mjete monedre dhe jo monedre) u rritën me 69.5% duke arritur shifrën prej 383 milionë euro në vitin 2011.

BKT është bankë e kujdesshme dhe me likuiditet.

BKT e ruan shëndetin dhe strukturën e portofolit të saj të huave nëpërmjet politikave të kujdesshme huadhënëse, menaxhimit efektiv dhe shpërndarjes së menduar mirë të riskut.

Banka ka ulur shifrën e kredive me probleme nga 8.47% në fund të vitit 2010 në 5.64% deri në fund të vitit 2011, e cila është mjaft poshtë mesatares së sektorit.

BKT-ja ka qenë autorja e projekteve novatore në Shqipëri në fushën e financës së strukturuar.

Në fund të vitit 2010 BKT nënshkroi një marrëveshje financiare tregtare me Korporatën Islamike Ndërkombëtare Financiare dhe Tregtare (ITFC). Sipas kësaj marrëveshje, grupi ka kryer transaksionin e parë murabaha në Shqipëri.

Një tjetër projekt huadhënës novator ku BKT është përfshirë ka marrë formën e një huaje 20 milionë dollarëshe për financimin e shfrytëzimit mineral në Afrikën e Veriut në vitin 2011. Me anë të kësaj marrëveshje BKT u bë banka e parë shqiptare që shtriu kreditimin në nivel ndërkombëtar, duke dëshmuar dhe një herë unikalitetin dhe leadershipin e saj.

BKT ka si synim të përfshihet më tej në operacionet e strukturuar financiare dhe në zgjerimin e objektit të aktiviteteve të saj në këtë fushë.

E-Banking për bizneset, produkt novator për vitin 2011.

BKT vazhdon të rrisë efikasitetin e shërbimeve dhe diversitetin e saj me shtimin e produkteve dhe shërbimeve të reja për bizneset. Një ndër shërbimet më të rëndësishme të këtij produkti ishte aplikimi e-banking për bizneset.

BKT organizon seminar për praktikën e tregtisë me jashtë.

Në përputhje me objektivin e saj për t'u ardhur më pranë klientëve të biznesit, BKT organizoi një seminar për praktikën e tregtisë me jashtë në prill të vitit 2011.



Seyhan Pencablıgil – Drejtori i Përgjithshëm i BKT-së, duke mbajtur fjalim në seminarin e organizuar nga BKT për praktikën e tregtisë me jashtë.



Në fushën e bankingut tregtar, BKT është angazhuar të kuptojë nevojat e klientëve të saj dhe të ofrojë zgjidhje specifike që i mbështesin klientët të arrijnë objektivat e biznesit të tyre.

Bankingu Tregtar

Në Grupin e Bankingut Tregtar ne jemi të angazhuar të kuptojmë nevojat e klientëve dhe të ofrojmë zgjidhje specifike që i mbështesin ata të arrijnë objektivat e biznesit të tyre.

2011 ka qenë një vit i suksesshëm për Grupin e Shërbimeve Bankare Tregtare.

Në vitin 2011 BKT ka ruajtur rritje të qëndrueshme në volumet e huadhënies dhe në numrin e klientëve.

- Portofoli i huasë arriti në 250,000,000 dollarë amerikanë me një rritje neto vjetore prej 48.29%.
- Numri i përgjithshëm i klientëve është rritur në 13.6%.
- Pjesa e Bankës në tregun e huadhënës të SME-ve është rritur me thuajse 2 pikë përqindje.



Pekhan Işıpek, Drejtori i Grupit të Bankingut Tregtar (në të djathtë) me Kryetaren e Kuvendit Znj. Jozefina Topalli dhe Ministrin e Bujqësisë dhe Ushqimit Z. Genc Ruli gjatë hapjes së Panairit të Agro-Biznesit.

Mbështetje e qëndrueshme për SME-të

BKT ka mbështetur një rritje të shëndetshme të SME-ve duke ofruar financime me kosto të ulët të marra nga institucionet ndërkombëtare;

- **Projekti italian i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (SME):** me qëllimin e rritjes së aksesit të SME-ve në kreditim, BKT po jep një kontribut të madh në suksesin e këtij programi afatgjatë me interesa të ulëta stimuluese. BKT u ka dhënë 5.8 milionë euro klientëve.
- **Programi i huasë i Fondit Europian për Europën Juglindore:** BKT kontribuoi për zhvillimin e më shumë se 230 SME-ve shqiptare me hua me një vlerë të përgjithshme prej 15,700,700 euro në vitin 2011.

Në 2011-n u prezantuan dy produkte të reja kreditimi

Duke i kushtuar vëmendje plotësisht të kërkesave të klientëve, BKT ka zhvilluar produkte që u përgjigjen më mirë nevojave të klientëve dhe për të merituar ndershmërinë e tyre.

- Hua fleksibël
- Financimi i llogarive të arkëtueshme
- Shërbimi e-banking e prezantuar së fundmi pritet të rrisë kënaqësinë e klientëve.
- Në vitin 2012 do të prezantohet "Karta e Biznesit për SME-të" duke u dhënë SME-ve akses të përshtatshëm, efektiv dhe të shpejtë në kreditim. Po ashtu kjo kartë do të inkurajojë marrëdhëniet financiare ndërmjet biznesit dhe furnitorëve.

Marrëdhëniet me sektorin publik po forcohen ndjeshëm

BKT vazhdon të forcojë marrëdhëniet e saj me sektorin publik jo vetëm në huadhënien në mjete monetare (cash), por dhe në pagimin e pagave, depozitat publike, në agroindustri dhe në huadhënien vendore.

- **Kreditë për Projektin Bujqësor AZHBR:** Në sektorin bujqësor, BKT ka vijuar të jetë kanali i preferuar për programin e Kredive për Projektin e Agro-Industriës. BKT kontrollon thuajse 50% të portofolit të huave në vitin 2011.
- **Projekti i USAID-it për Financimin e Qeverive Vendore:** lehtësira për garantimin e financimit për qeverinë vendore, BKT është banka më aktive në këtë linjë biznesi.



Në sektorin bujqësor, BKT ka vijuar të jetë kanali i preferuar për programin e Kredive për Projektin e Agro-Industriës.

BKT do të vazhdojë të luajë rol të rëndësishëm në financimin publik nëpërmjet zbatimit të produkteve të reja dhe bashkëpunimit me institucionet e brendshme dhe ndërkombëtare për të krijuar projekte me vlerë të shtuar në të ardhmen.



Pozicionimi i rëndësishëm i BKT-së në financimin e tregtisë së huaj në Shqipëri ka nxitur rritjen e Bankës në këtë zë biznesi në vitin 2011.

Thesari dhe Institucionet Financiare

Përgjatë të gjithë vitit 2011, BKT ka mbajtur nën vëzhgim zhvillimet e tregjeve kombëtare dhe ndërkombëtare në përpjekje për të siguruar financimin që kërkohet prej Bankës. BKT ka pasur po ashtu një vit të suksesshëm në realizimin e operacioneve të saj të thesarit në vitin 2011 në pozicionin e saj si një ndër bankat kryesore në vend dhe në tregjet e këmbimit valutor. Duke përfituar nga niveli i saj i lartë i likuiditetit, banka prezantoi shërbimin e ofrimit të financimit për eksportuesit vitin që shkoi. Në të njëjtin zë, BKT-ja bleu letra premtimi të cilat i mori duke marrë pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë në bashkëpunim me bankat ndërkombëtare. Këto marrëveshje, të cilat kanë kohëzgjatje prej më pak se një vit, kanë kontribuar shumë në nivelin e fitimit të BKT-së.



Duke përfituar nga niveli i saj i lartë i likuiditetit, banka prezantoi shërbimin e ofrimit të financimit për eksportuesit vitin që shkoi.

Duke përfituar nga marrëdhënia me besim të ndërsjellë, Banka rriti pjesën e saj në tregun shumë konkurrues të depozitave në nivelin prej rreth 18%.

Në përpjekje për të rritur vizibilitetin dhe reputacionin e saj në arenën ndërkombëtare, BKT kërkon të krijojë marrëdhënie të forta si me bankat simotra dhe me institucionet e tjera financiare ndërkombëtare. Gjatë vitit 2011, u kryen vizita homologe në mbi 80 banka, të cilat shërbyen për sigurimin e limiteve financiare të tregtisë së jashtme me mbi 30 banka të huaja. Pozicionimi i rëndësishëm i BKT-së në financimin e tregtisë së jashtme të Shqipërisë ka çuar më tej rritjen e këtij zëri biznesi në vitin 2011.

Vitin që shkoi BKT u bë anëtar i drejtpërdrejtë i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC). BKT po përgatitet ndërkohë për iniciativën e krijimit të një komiteti kombëtar të ICC-së në Shqipëri.

Në përpjekjet e saj të vazhdueshme për të kërkuar dhe për të arritur tregje të tjera nga ku Shqipëria mund të marrë hua, BKT po angazhohet në kontakte dhe në diskutime në vendet e Rajonit të Gjirit. Një objektivi i këtyre përpjekjeve është emetimi i bonove shqiptare pa interes (bonot sukuk).


Grupi i Menaxhimit të Riskut

Grupi i Menaxhimit të Riskut është përfshirë në mënyrë aktive në proceset e menaxhimit të ekspozimit të kredive me probleme gjatë 2011-s. Megjithëse pritej që përkeqësimi i treguesve makroekonomikë të çonte në ekspozim më të madh të kredive me probleme në vitin 2011, qasja aktive në fakt e uli nivelin e këtyre kredive nga 8.4% në fund të vitit 2010 në 5.6% në fund të vitit 2011. Kjo shifër është shumë e favorshme nëse krahasohet me nivelin mesatar të huave të këqija në industrinë e bankave në Shqipëri, e cila në fund të vitit 2011 ishte 19%.

Faktori më i rëndësishëm për menaxhimin e kredive me vonesa ka qenë monitorimi i gjerë dhe efektiv i tyre, në veçanti në rastin e subjekteve të reja. Po ashtu, ngritjet e padive ligjore në mënyrë më strikte dhe më të shpeshtë, kanë shërbyer po ashtu për rritjen e ndërgjegjësimit të klientëve për detyrimet e shërbimit të tyre të borxhit gjatë vitit 2011.



BKT ka pasur një vit të suksesshëm dhe në realizimin e operacioneve të saj të thesarit në vitin 2011 në pozicionin e saj si një ndër bankat kryesore të vendit në tregjet e parasë dhe të këmbimit valutor.



Struktura organizative dinamike dhe fleksibël jo

vetëm i lejon BKT-së të përshtatet me kërkesat e kohës dhe të plotësojë nevojat e Bankës, por njëkohësisht ndihmon dhe në përmirësimin e shpejtësisë dhe të cilësisë së shërbimit.

Burimet Njerëzore

Duke ditur se çdo punonjës kontribuon për kapitalin intelektual të Bankës, BKT i kushton rëndësi identifikimit, rekrutimit dhe punësimit të njerëzve që janë të përshtatshëm për kulturën e biznesit të saj, të cilët janë të kualifikuar dhe produktiv dhe që zotërojnë njohuritë dhe eksperiencën që kërkohet për të kryer punën. Nga fillimi deri në fund të vitit 2011, numri i personelit të Bankës u rrit nga 922 në 1,059 vetë.

Struktura organizative dinamike dhe fleksibël jo vetëm i lejon BKT-së të përshtatet me kërkesat e kohës dhe të plotësojë nevojat e Bankës, por njëkohësisht ndihmon dhe në përmirësimin e shpejtësisë dhe të cilësisë së shërbimit.



Puna në grup inkurajohet në çdo nivel në mënyrë që të krijohet dhe të ruhet një mjedis përfitues pune.

BKT është e përqendruar fort në zhvillimin e karrierës. Transferimet në punë, rotacionet dhe ngritjet në detyrë përdoren për të mbështetur si objektivat e karrierës të punonjësve dhe nevojat organizative të Bankës. Rreth 13% e personelit të Bankës janë ngritur në detyrë gjatë vitit 2011. Norma e largimit të personelit është mjaft e ulët, gjë e cila konsiderohet si faktor i rëndësishëm që luan rol në suksesin e Bankës. Zbatimi i Programit të Kredisë për Ruajtjen e Stafit ka ndihmuar në rritjen e mbajtjes në Bankë të personelit të lartë drejtues dhe të stafit me eksperiencë.

Praktikat e Burimeve Njerëzore janë mbështetur po ashtu me anë të novacioneve teknologjike. Në vitin 2011, programi SAP i bankës u zgjerua për të përfshirë të gjitha operacionet e burimeve njerëzore. Kjo do të lejojë gjithashtu regjistrimin më të mirë të proceseve të rekrutimit, të menaxhimit të të dhënave të personelit dhe të zhvillimit të trajnimit duke përsheptuar po ashtu vendimmarrjet përkatëse.

Puna në grup inkurajohet në çdo nivel në mënyrë që të krijohet dhe të ruhet një mjedis përfitues pune. Çdo punonjës ka mundësinë e përmirësimit të kompetencave të tij dhe rritjes së mundësive për karrierë nëpërmjet programeve të trajnimit. Programet dhe seminarët e trajnimit të personelit dhe të zhvillimit të karrierës që janë realizuar gjatë të gjithë vitit 2011 kanë çuar në një kohë mesatare trajnimi prej shtatë ditësh për person. Gjatë të gjithë vitit janë realizuar gjithsej 160 seminare.

"Programi i Studimit FASTIP" në Fakultetin e Studimeve të Integruara me Praktikën të Universitetit "Aleksandër Moisiu" në Durrës shihet si një shembull i shkëlqyer i partneritetit publik-privat që sjell sëbashku përpjekjet e institucioneve arsimore dhe nevojat e sektorit privat. Duke ofruar eksperiencë teorike dhe praktike në fushën bankare dhe në financë, ky program i dyfishtë studimi i përgatit studentët për karrierë në industrinë bankare. Në shtator të vitit 2011 u diplomua brezi i parë i studentëve të FASTIP-it. Të gjithë këta studentë tani janë të punësuar në BKT. Banka po ofron aktualisht një program mbështetës financiar dhe praktik për 70 studentë të FASTIP-it dhe synon të shtojë mbështetjen dhe për 25 studentë të tjerë në vitin 2012.



Seyhan Pencablğil – Drejtori i Përgjithshëm i BKT-së duke shpërndarë diplomat në ceremoninë e diplomimit në Fakultetin e Studimeve të Integruara me Praktikën (FASTIP) të Universitetit "Aleksandër Moisiu" në Durrës.



Për të ndihmuar në mbështetjen e Somalisë, BKT mori pjesë në fushata ndihme të organizuara bashkërisht me Gjysmëhënën e Kuqe Turke, gazetën "Sabah" dhe Agjencinë Ndërkombëtare për Bashkëpunim dhe Zhvillim.

Përgjegjshmëria Sociale e Korporatës

BKT i kushton rëndësi të madhe zhvillimit të shoqërisë shqiptare ndërkohë që mbështet fushatat ndërkombëtare të ndihmës.

Gjatë vitit 2011 BKT ka marrë pjesë në disa projekte të përgjegjshmërisë sociale:

- Banka organizoi dhe mbështeti një fushatë ndihme për viktimat e përmytjeve të Shkodrës.
- "Dita e Dhurimit të Gjakut", ku punonjësit e BKT-së u inkurajuan të merrnin pjesë vullnetarisht, shërbeu dhe si një platformë efektive për komunikimin social bazuar në solidaritet.
- Në Nigeri, në një ndër vendet më të varfra të botës që vuan nga mungesa e madhe e ujit të pijshëm të pastër, BKT-ja mori pjesë po ashtu në fushatën "Pusi i Ujit Çaluk në Nigeri", e cila u ndërmor me mbështetjen e të gjithë Grupit Çaluk.
- Për të ndihmuar Somalinë, një vend që ka vuajtur nga thatësi ndër më të ashprat të gjashtëdhjetë viteve të fundit dhe ku jetojnë rreth 11 milionë njerëz shumë pranë niveleve të vdekjes nga uria, BKT mori pjesë në një fushatë ndihme të organizuar bashkërisht me gazetën Sabah, Gjysmëhënën e Kuqe Turke dhe Agjencinë Ndërkombëtare për Bashkëpunim dhe Zhvillim (TİKA).
- Gjatë vitit BKT organizoi një sërë aktiviteteve sociale dhe kulturore me synim mbështetjen dhe ndihmën për studentë në qarkun e Tiranës.



Një ndër principet kryesorë të qasjes së përgjegjshmërisë sociale të BKT-së është rëndësia që i jep ajo arsimit.



Në Nigeri, BKT mori pjesë në fushatën "Pusi i Ujit Çaluk në Nigeri", e ndërmarrë me mbështetjen e të gjithë Grupit Çaluk.

- Në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës, BKT-ja kontribui për dekorimet e Vitit të Ri përgjatë dy rrugëve më të rëndësishme të qytetit, përkatësisht në bulevardin Dëshmorët e Kombit dhe në bulevardin Zhan D'Ark.

Një ndër principet kryesorë të qasjes së përgjegjshmërisë sociale të BKT-së është rëndësia që i jep ajo arsimit. Për realizimin e këtij qëllimi, Banka sponsorizon programe arsimimi. BKT i inkurajon studentët më të mirë duke u dhënë atyre bursa vjetore. Vëmendje e veçantë u kushtohet atyre që studiojnë financë dhe ekonomiks.



"Dita e Dhurimit të Gjakut", në të cilën punonjësit e BKT-së u inkurajuan të merrnin pjesë vullnetarisht, shërbeu si një platformë efektive për komunikimin social bazuar në solidaritet.




BKT do të vazhdojë të japë më shumë fonde

për të plotësuar nevojat në rritje të klientëve të saj ndërsa realizon mundësi më të sigurta dhe më të zgjuara investimi për ta.

Planet për 2012-n

BKT do të punojë për të rritur bilancin e saj me 25% në vitin 2012. Objektivi i rritjes së Bankës për depozitat, të cilat priten të arrijnë në 2 miliardë dollarë, është 26%. Rritja në huadhënie pritet të jetë më pak e lartë, me rreth 20%, ku pjesa më e madhe e huave do të jenë në kategorinë e monedhës vendase, duke i kushtuar më shumë vëmendje individëve. Fitimi neto për këtë vit synohet të jetë 40 milionë dollarë, duke realizuar një nivel kthimi të kapitalit prej 30% dhe duke e çuar kapitalin e aksionerëve në 179 miliardë dollarë.



BKT do të vazhdojë të marketojë furishëm huatë për individët me qëllimin e arritjes së 18% të tregut.

Grupi i Bankingut të Korporatave:

- parashikon një rritje prej 16% në portofolin e përgjithshëm të huave për korporatat;
- do të përqendrohet në rritjen e peshës relative të llogarive në lek në portofolin e huave;
- do të prezantojë dy produkte të reja huadhënie: "Overdraftin" dhe "Huanë e Koleratizuar";
- do të prezantojë modulën e shërbimeve bankare me internet për biznesin.

Grupi i Bankingut Tregtar:

- do të vazhdojë të japë më shumë fonde për të realizuar nevojat në rritje të klientëve të saj, ndërkohë që realizohen mundësi më të sigurta dhe më të zgjuara investimi për ta;
- do të përfundojë disa projekte të filluara në vitin 2011, në veçanti kartën e biznesit të SME-ve, Marrëveshjen me Agjencinë e Zhvillimit të Zonave Malore, projektet me

KfW-në për mbështetjen e investimeve energjitike me efikasitet të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe për ofrimin e financimeve për ndërmarrjet e mesme dhe të vogla në zonat rurale.

Grupi i Bankingut Individual:

- do të vazhdojë të përqendrohet tek fitimi nga mundësitë e shitjeve, të kombinuara nëpërmjet Departamentit të Shitjeve për Individët, i cili është krijuar së fundmi e të cilit i janë dhënë përgjegjësi të plota për realizimin e këtyre shitjeve;
- do të vazhdojë të tregtojë fuqimisht huatë për individët me qëllimin e mbulimit të 18% të tregut;
- do t'i kushtojë vëmendje më të madhe përdorimeve të kanaleve alternative të ofrimit me qëllim arritjen e pjesës së tregut në nivelin e 17% dhe 14% përkatësisht në transaksionet në ATM dhe POS;
- do të ketë gjithsej 20,000 përdorues kartash krediti në portofolin e saj në fund të vitit;
- do të rrisë numrin e përgjithshëm të pagesave të faturave të shërbimeve nëpërmjet kanaleve të saj deri në masën 50%.

Grupi i Menaxhimit të Riskut:

- do të vazhdojë të përqendrohet në ruajtjen e nivelit të huave të këqija në minimalen absolute;
- do të punojë për përmirësimin e standardeve të menaxhimit të riskut në mënyrë që ato të jenë në përputhje me praktikën aktuale; do të përpiqet të arrijë objektivat e treguesit të performancës së Bankës duke marrë parasysh interesat e të gjithë aktorëve.

Grupi i Financës dhe i Teknologjisë së Informacionit:

Prioriteti i Grupit të Financës dhe TI do të jetë përditësimi i sistemit bazë të bankingut, i cili gjithashtu në bashkëpunim me Grupin e Auditit të Brendshëm do të koordinojë me Çalik Holding zbatimin e sistemit "rezultat i balancuar".

Divizioni i Rrjetit:

- do të shtojë pesë njësi të reja, duke e çuar numrin e përgjithshëm në 85;
- do të prezantojë një proces të ri stimuluesh dhe performance dhe një program individual;
- do të punojë për rritjen e efektivitetit dhe të efikasitetit të rrjetit.

Banka Kombetare Tregtare Sh.a.

Pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2011

(me raportin e audituesve të pavarur bashkëngjitur)

Përmbajtja

	Faqe
RAPORTI I AUDITUESVE TË PAVARUR	i - ii
PASQYRAT FINANCIARE TË KONSOLIDUARA:	
PASQYRA E KONSOLIDUAR E POZICIONIT FINANCIAR	1
PASQYRA E KONSOLIDUAR E TË ARDHURAVE PËRMBLEDHËSE	2
PASQYRA E KONSOLIDUAR E NDRYSHIMEVE NË KAPITALIN E VET	3-4
PASQYRA E KONSOLIDUAR E FLUKSEVE TË PARAVE	5
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE TË KONSOLIDUARA	6 – 62



KPMG Albania Sh.p.k
"Dëshmorët e Kombit" Blvd
Twin Towers Buildings
Building 1, 13th floor
Tirana, Albania

Telephone +355(4)2274 524
+355(4)2274 534
Telefax +355(4)2235 534
E-mail al-office@kpmg.com
Internet www.kpmg.al

Raporti i Audituesve të Pavarur

Aksionerit dhe drejtuesve të
Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Tiranë, 20 shkurt 2012

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të konsoliduara bashkëngjitur të Bankës Kombëtare Tregtare sh.a. ("Banka"), të cilat përbëhen nga pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2011, pasqyrat e konsoliduara të të ardhurave përmbledhëse, ndryshimeve në kapitalin e vet dhe flukseve të parave për vitin e mbyllur në atë datë, dhe shënimet që përfshijnë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare të konsoliduara

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për një kontroll të brendshëm, të tillë siç drejtimi vendos se është i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara pa anomali materiale, të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Përgjegjësia e Audituesve

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare të konsoliduara bazuar në auditimin tonë. Auditimi ynë u bë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarte kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të marrim një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare të konsoliduara nuk kanë anomali materiale.

Auditimi ka të bëjë me kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare të konsoliduara. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare të konsoliduara, si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Kur vlerësojmë këto rreziqe, ne marrim në konsideratë kontrollin e brendshëm të entitetit mbi përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare të konsoliduara në mënyrë që të planifikojmë procedura të përshtatshme auditimi në rrethanat përkatëse të entitetit, por jo me qëllim që të shprehim një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së metodave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, si dhe me vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare të konsoliduara.

Ne besojmë që evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.



Opinion

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të konsoliduara paraqesin në mënyrë të sinqertë, në të gjitha aspektet materiale, gjendjen financiare të konsoliduar të Bankës më 31 dhjetor 2011, rezultatin e saj financiar të konsoliduar dhe flukset e saj të konsoliduara të parave për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

KPMG Albania Shpk

KPMG Albania Sh.p.k.
“Deshmoret e Kombit” Blvd.
Twin Towers Buildings
Building 1, 13th floor
Tirana, Albania

Banka Kombetare Tregtare Sh.a.**Pasqyra e konsoliduar e të ardhurave përmbledhëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2011**

(shprehur në USD)


	Shënime	31 dhjetor 2011	31 dhjetor 2010
Aktivet			
Arka dhe llogaritë me Bankën Qendrore	7	190,597,582	177,385,066
Depozita dhe llogaritë me bankat	8	114,409,670	113,703,073
Bono thesari	9	209,153,101	187,826,686
Investime të vlefshme për shitje	10	143,171,647	101,714,745
Investime të mbajtura deri në maturim	11	288,885,306	275,915,418
Hua dhe paradhënie për bankat	12	98,888,938	68,810,445
Hua dhe paradhënie për klientët	13	778,063,334	551,045,870
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	14	18,722,658	16,475,450
Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara	15	1,699,447	1,610,738
Aktive të tjera	16	21,097,162	8,414,055
Totali i aktiveve		1,864,688,845	1,502,901,546
Detyrimet dhe kapitali aksionar			
Detyrimet			
Detyrime ndaj klientëve	17	1,581,303,036	1,309,651,520
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	18	130,867,465	62,398,988
Detyrime ndaj palëve të treta	19	3,018,872	2,151,892
Detyrime tatimore të shtyra	20	2,374,663	1,731,801
Detyrime të tjera	21	8,960,296	8,297,498
Totali i detyrimeve		1,726,524,332	1,384,231,699
Kapitali aksionar			
Kapitali i aksionar i paguar	22	100,000,000	84,622,200
Rezerva e rivlerësimit	22	(2,748,295)	(34,349)
Rezerva e vlerës së drejtë	22	(7,222,165)	342,874
Fitimi i pashpërndarë	22	48,134,973	33,739,122
Totali i kapitalit aksionar		138,164,513	118,669,847
Totali i detyrimeve dhe kapitalit aksionar		1,864,688,845	1,502,901,546

Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare të konsoliduara nga faqja 6 deri në faqen 62, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Pasqyrat financiare të konsoliduara u autorizuan nga Këshilli Drejtues më 25 janar 2012 dhe u nënshkruan në emër të tij nga:



Seyhan Pencablil
Drejtor i Përgjithshëm dhe
Anëtar i Këshillit Drejtues



Skender Emini
Drejtor i Grupit të Financës
dhe TI

Banka Kombetare Tregtare Sh.a.**Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në kapitalin e vet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2011**

(shprehur në USD)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2011	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2010
Interesi			
Të ardhura nga interesi	23	123,535,207	104,360,345
Shpenzime interesi	24	(57,638,540)	(49,672,970)
Të ardhura nga interesi, neto		65,896,667	54,687,375
Të ardhura të tjera, neto nga veprimtaria bankare			
Tarifa dhe komisione, neto	25	7,782,634	4,426,426
Fitimi neto nga rivlerësimi i valutave	26	729,345	1,286,830
Fitimi neto nga këmbimet valutore		691,213	1,843,633
Shpenzime të tjera, neto	27	(374,303)	(297,222)
Totali i të ardhurave të tjera neto nga veprimtaria bankare		8,828,889	7,259,667
Shpenzime operative			
Shpenzime personeli	28	(14,709,307)	(12,335,056)
Shpenzime administrative	29	(18,447,698)	(15,749,247)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	14,15	(4,542,526)	(4,280,684)
Totali i shpenzimeve operative		(37,699,531)	(32,364,987)
Zhvlerësimi i huave	13	(4,082,609)	(1,643,974)
Fitimi para tatimit		32,943,416	27,938,081
Tatimi mbi fitimin	30	(3,528,782)	(2,935,112)
Fitimi neto i vitit		29,414,634	25,002,969
Diferenca konvertimi të monedhave të huaja		(2,713,946)	174,944
Ndryshimet neto në rezervën e vlerës së drejtë		(7,565,039)	286,200
Other comprehensive (loss) / income for the year, net of income tax		(10,278,985)	461,144
Total comprehensive income for the year		19,135,649	25,464,113

Pasqyra e konsoliduar e të ardhurave përmbledhëse duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare të konsoliduara nga faqja 6 deri në faqen 62, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.**Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në kapitalin e vet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2011**

(shprehur në USD)

Kapitali aksionar i paguar	Rezerva e rivlerësimit	Rezerva e vlerës së drejtë	Fitimi i pashpërndarë	Totali
78,299,000	(209,293)	56,674	16,524,273	94,670,654
6,323,200	-	-	(6,323,200)	-
-	-	-	(209,293)	(209,293)
-	-	-	(1,255,627)	(1,255,627)
6,323,200	-	-	(7,788,120)	(1,464,920)
-	-	-	25,002,969	25,002,969
-	-	286,200	-	286,200
-	174,944	-	-	174,944
-	174,944	286,200	-	461,144
-	174,944	286,200	25,002,969	25,464,113
84,622,200	(34,349)	342,874	33,739,122	118,669,847

Gjendja më 1 janar 2010**Veprimet me pronarët të regjistruara direkt në kapital**

Totali i kontributeve nga pronarët dhe shpërndarjeve për pronarët

Rritja e kapitalit të paguar

Kthimi i diferencave të rivlerësimit të vitit 2009

Rregullimi i fitimit të pashpërndarë me kursin e fund vitit 2010

Totali i kontributeve nga pronarët dhe shpërndarjeve për pronarët

Totali i të ardhurave përmbledhëse për vitin

Fitimi neto i vitit

Të ardhura të tjera përmbledhëse, neto pas tatimit

Ndryshimet neto në rezervën e vlerës së drejtë

Diferenca konvertimi të monedhave të huaja

Totali i të ardhura të tjera përmbledhëse

Totali i të ardhurave përmbledhëse për vitin

Gjendja më 31 dhjetor 2010

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.**Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në kapitalin e vet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2011**

(shprehur në USD)

	Kapitali aksionar i paguar	Rezerva ligjore	Rezerva e rivlerësimit	Rezerva e vlerës së drejtë	Fitimi i pashpërndarë	Totali
Gjendja më 1 janar 2011	84,622,200	-	(34,349)	342,874	33,739,122	118,669,847
Veprimet me pronarët të regjistruara direkt në kapital						
Totali i kontributeve nga pronarët dhe shpërndarjeve për pronarët	-	4,024,442	-	-	(4,024,442)	-
Krijimi rezervës ligjore	15,377,800	(4,112,047)	-	-	(11,265,753)	-
Rritja e kapitalit të paguar	-	87,605	-	-	(87,605)	-
Rregullimi i konvertimit të rezervës ligjore	-	-	-	-	(34,349)	(34,349)
Kthimi i diferencave të rivlerësimit të vitit 2010	-	-	-	-	-	-
Rregullimi i fitimit të pashpërndarë me kursin e fund vitit 2011	-	-	-	-	393,366	393,366
Totali i kontributeve nga pronarët dhe shpërndarjeve për pronarët	15,377,800	-	-	-	(15,018,783)	359,017
Totali i të ardhurave (humbjes) përmbledhëse për vitin	-	-	-	-	29,414,634	29,414,634
Fitimi neto i vitit	-	-	-	-	-	-
Të ardhura të tjera përmbledhëse, neto pas tatimit						
Ndryshimet neto në rezervën e vlerës së drejtë	-	-	-	(7,565,039)	-	(7,565,039)
Diferenca konvertimi të monedhave të huaja	-	-	(2,713,946)	-	-	(2,713,946)
Totali i humbjeve të tjera përmbledhëse	-	-	(2,713,946)	(7,565,039)	-	(10,278,985)
Totali i të ardhurave (humbjes) përmbledhëse për vitin	-	-	(2,713,946)	(7,565,039)	29,414,634	19,135,649
Gjendja më 31 dhjetor 2011	100,000,000	-	(2,748,295)	(7,222,165)	48,134,973	138,164,513

The consolidated statement of changes in equity is to be read in conjunction with the notes to and forming part of the consolidated financial statements set out on pages 6 to 62.

Banka Kombetare Tregtare Sh.a.**Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2011**

(shprehur në USD)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2011	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2010
Flukset e parave nga aktivitetet operacionale:			
Fitimi para tatimit		32,943,416	27,938,081
Rregullime për të barazuar ndryshimet në aktivet neto me fluksin neto të parave nga aktivitetet operacionale:			
Shpenzime interesi	24	57,638,540	49,672,970
Të ardhura nga interesi	23	(123,535,207)	(104,360,345)
Amortizimi dhe zhvlerësimi	14, 15	4,542,526	4,280,684
Fitimi nga shitja e aktiveve të trupëzuara		(23,418)	(21,314)
Fitimi nga shitja e bonove të thesarit		(23,441)	(84,253)
Fitimi nga shitja e aktiveve të fituara me proces ligjor		(49,500)	(22,644)
Fitimi nga arkëtimi i kredive të humbura		(17,526)	(8,697)
Nxjerrje jashtë përdorimit e aktiveve të trupëzuara		22,866	5,498
Nxjerrje jashtë përdorimit e inventarit të imët		-	500
Humbje nga kreditë e humbura të pakthyeshme		129,352	185,425
Provizione për debitorë të tjerë		1,790,193	429,874
Lëvizje në rezervën e vlerës së drejtë		(8,053,243)	290,859
Provizione për humbjet nga huatë	13	4,082,609	1,643,974
Flukset e parave nga fitimet operacionale para ndryshimeve në aktive dhe detyrime operacionale		(30,552,833)	(20,049,387)
(Rritja)/ Pakësimi i aktiveve operacionale:			
Llogaritë e kufizuara me bankën qendrore		(27,959,068)	(12,612,177)
Depozita dhe llogari me bankat		15,215,804	(22,038,456)
Hua dhe paradhënie për bankat		(34,081,501)	(26,626,774)
Hua dhe paradhënie për klientët		(265,452,387)	(94,767,017)
Aktive të tjera		(15,557,755)	(3,315,958)
		(327,834,907)	(159,360,382)
Rritja/ (Pakësimi) i detyrimeve operacionale:			
Detyrime ndaj klientëve		331,810,541	232,418,730
Detyrime ndaj palëve të treta		999,828	1,732,586
Detyrime të tjera		929,523	(560,073)
		333,739,892	233,591,243
Interesi i paguar		(53,535,085)	(47,464,286)
Interesi i arkëtuar		121,839,423	97,604,982
Tatimi fitimi i paguar		(2,714,334)	(1,743,779)
Flukset neto të parës nga aktivitetet operacionale		40,942,156	102,578,391
Flukset e parave nga aktivitetet investuese			
Blerje e investimeve		(70,566,219)	(148,555,172)
(Blerje)/ shlyerje e bonove të thesarit		(36,991,745)	34,243,000
Blerje e aktiveve të trupëzuara		(7,692,970)	(3,150,165)
Hyrje nga shitja e aktiveve të trupëzuara		25,888	44,672
Hyrje nga shitja e bonove të thesarit		8,718,558	12,944,904
Paraja neto e përdorur në aktivitetet investuese		(106,506,488)	(104,472,761)
Flukset e parave nga aktivitetet financuese			
Hyrje/(shlyerje) nga huatë afatshkurtra		74,848,004	(1,381,476)
Neto e gjeneruar/(përdorur) nga aktivitetet financuese		74,848,004	(1,381,476)
Rritja/(rënia) neto e parës dhe ekuivalentëve të saj		9,283,672	(3,275,846)
Diferencat në kursin e këmbimit		(3,511,912)	(5,052,573)
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit	7	141,352,804	149,681,223
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit	7	147,124,564	141,352,804

Pasqyra e konsoliduar e flukseve të parave duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare të konsoliduara nga faqja 6 deri në faqen 62, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2011

(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

1. Të përgjithshme

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a. është një bankë tregtare që ofron një gamë të gjerë me shërbime të plota. Pasqyrat e konsoliduara financiare përfshijnë Bankën dhe degën e saj në Kosovë (referuar së bashku në vazhdim si "Banka", ose "BKT").

Banka ofron shërbime bankare për ndërmarrje shtetërore e private dhe individë. Burimi kryesor i fondeve për Bankën janë depozitat, të cilat Banka i pranon në forma të ndryshme duke përfshirë llogaritë rrjedhëse, depozita me dhe pa afat, si në Lek ashtu edhe në valutë. BKT ofron: një shumëllojshmëri të kredive për biznese dhe individë, karta krediti dhe debiti në përputhje me standartin EMV, bankomate, bankingu në internet, bankingu në telefon celular, shërbime bankingu on-line, shërbim të kualifikuar të bankingut ndërkombëtar dhe produkte të ndryshme thesari. Gjithashtu, ajo investon në letra me vlerë dhe merr pjesë aktivisht në tregun ndërbankar lokal dhe ndërkombëtar.

BKT është krijuar në formën aktuale ligjore më 30 dhjetor 1992, megjithëse dega e saj e parë është hapur më 30 nëntor 1925. BKT është subjekt i Ligjit nr. 8269 "Mbi Bankën e Shqipërisë" me datë dhjetor 1997 dhe i Ligjit nr. 9662 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë", të datës 18 dhjetor 2006.

Në bazë të Vendimit të Aksionarëve të marrë në datën 31 mars 2011, Banka krijoi rezervën ligjore prej 398,581 mijë Lek (ekuivalente e 4,024,442 USD), duke përdorur një pjesë të fitimit të pashpërndarë për vitin 2010.

Në bazë të Vendimit të Aksionarëve të marrë në datën 17 gusht 2011, Banka rriti kapitalin e saj të paguar me shumën 1,490,570 mijë Lek (ekuivalenti në USD 15,377,800), duke përdorur rezervën ligjore prej 398,581 mijë Lek (ekuivalente e 4,112,047 USD) si edhe një pjesë të fitimit të saj të pashpërndarë prej 1,091,989 mijë Lek (ekuivalente e 11,265,753 USD). Rritja e kapitalit u konvertua në USD me kursin e këmbimit të publikuar nga Banka e Shqipërisë për datën 17 gusht 2011 (96.93 Lek për USD).

Pas kësaj rritjeje të kapitalit, struktura aksionare nuk pësoi ndryshim, sikurse dhe vlera nominale e aksioneve në vlerën 12.35 USD, ndërkohë që numri i aksioneve u rrit me 1,245,166. Struktura aksionare më datë 31 dhjetor 2011 dhe 31 dhjetor 2010 ishte si më poshtë:

	31 dhjetor 2011			31 dhjetor 2010		
	Nr. i aksioneve	Totali USD	%	Nr. i aksioneve	Totali USD	%
Calik Finansal Hizmetler A.S.	8,097,166	100,000,000.10	100	6,852,000	84,622,200	100

Drejtoria e Përgjithshme e BKT ndodhet në Tiranë. Aktualisht në Shqipëri, Banka zotëron një rrjet prej 54 degësh dhe 3 agjencish doganore. Tetëmbëdhjetë prej degëve ndodhen në Tiranë dhe të tjerat në Durrës, Elbasan, Vlorë, Shkoder, Fier, Pogradec, Korce, Bilisht, Gjirokastrë, Delvine, Sarandë, Orikum, Berat, Kucovë, Lushnjë, Librazhd, Peqin, Rrogozhinë, Shkozë, Kavajë, Vore, Kamzë, Fushe Krujë, Lac, Lezhë, Rreshen, Kukes, Peshkopi, Bushat dhe Koplak, të ndjekura nga agjencitë doganore në Kakavijë, Portin e Durrësit dhe Aeroportin e Rinasit. Gjatë vitit 2011, Banka hapi një degë të re në Vlorë dhe mbylli një degë në Tiranë.

Rrjeti në Kosovë përfshin 23 njësi. Pesë njësi ndodhen në Prishtinë, ndërsa të tjerat janë të vendosura në Prizren, Pejë, Gjiilan, Ferizaj, Mitrovicë, Gjakovë, Vushtrri, Fushë Kosovë, Podujevë, Drenas, Rahovec, Viti dhe Lipjan, Hani i Elezit, Dheu i Bardhe dhe Aeroporti i Prishtinës. Në vitin 2011 Banka hapi tetë njësi të reja në Kosovë.

Banka kishte 1,059 punonjës (2010: 922) në datën 31 Dhjetor 2011, nga të cilët 254 (2010: 171) i përkasin Degës së Kosovës.

Banka Kombetare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2011

(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

2. Bazat e përgatitjes

(a) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ('SNRF') të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ('BSNK').

(b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur bazuar në kosto historike, përveç instrumenteve financiare të gatshme për shitje, të cilët janë matur me vlerën e drejtë, investimeve në pronë, të cilat janë matur me vlerën e drejtë dhe aktiveve afatgjata të mbajtura për shitje, të cilat janë matur me vlerën më të ulët mes vlerës së mbetur dhe vlerës së drejtë, duke i zbritur kostot.

(c) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare të konsoliduara paraqiten në USD. Monedha funksionale e Bankës është Lek.

Banka ka zgjedhur ti prezantojë pasqyrat financiare në USD, meqënese kapitali i saj është i zotëruar plotësisht nga investitorë ndërkombëtarë, të cilët kanë kontribuar kapitalin fillestar në USD dhe e vëzhgojnë performancën e investimit në USD.

(d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga këto vlerësime.

Çmuarjet dhe supozimet bazë rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në periudhën në të cilën çmuarja rishikohet si dhe në periudhat e ardhme nëse ato ndikohen.

Informacioni mbi elementët e rëndësishëm të pasigurive të vlerësimit dhe mbi gjykimet kritike në përdorimin e politikave kontabël me efekt të rëndësishëm në vlerat kontabël në pasqyrat financiare të konsoliduara, jepet në shënimet 4 dhe 5.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme në të gjitha periudhat e prezantuara në këto pasqyra financiare të konsoliduara dhe në mënyrë të njëjtë nga njësitë e Bankës.

(a) Baza e konsolidimit

(i) Filialet

Filialet janë njësi (degë) të kontrolluara nga Banka. Kontrolli ekziston atëherë kur Banka ka fuqinë të drejtë të politikave financiare dhe operacionale të një njësie, me qëllim që të përftojë nga aktivitetet e saj. Në vlerësimin e kontrollit, merren në konsideratë të drejtat potenciale votuese që janë aktualisht në fuqi. Pasqyrat financiare të filialeve janë të përfshira tek pasqyrat financiare të konsoliduara që nga data e fillimit të kontrollit deri në datën e mbarimit të tij. Pasqyrat financiare janë përgatitur duke u bazuar në politika kontabël uniforme për veprime të ngjashme dhe çështje të tjera në kushte të njëjta.

Në datën 3 shtator 2007, BKT hapi degën e saj të parë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Zyra Administrative e kësaj dege u hap në qytetin e Prishtinës, Kosovë.

3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(a) Baza e konsolidimit (vazhdim)

(ii) Veprimet e eliminuara gjatë konsolidimit

Tepricat brenda grupit, dhe të ardhurat dhe shpenzimet që vijnë nga veprimet brenda grupit (me përjashtim të fitimeve ose humbjeve nga veprime në monedhë të huaj), janë eliminuar gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare të konsoliduara. Humbjet e perealizuara janë eliminuar në të njëjtën mënyrë si fitimet e perealizuara, por deri në masën që nuk ka evidencë për rënie të vlerës.

(b) Monedha të huaja

(i) Veprimet në monedhë të huaja

Veprimet në monedhë të huaj janë kthyer në monedhën funksionale respektive me kursin e këmbimit të datës kur është kryer veprimi. Aktivitet dhe pasivitet monetare, të shprehura në monedhë të huaj në datën e raportimit janë kthyer në monedhën funksionale, me kursin e këmbimit të asaj date. Fitimi apo humbja nga kursi i këmbimit i instrumenteve monetare, është ndryshimi midis kostos së amortizuar në monedhë funksionale në fillim të periudhës, e regulluar kjo për interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të kthyer në monedhën funksionale, me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Aktivitet dhe detyrimet jo monetare në monedhë të huaj, që maten me vlerë të drejtë, kthehen në monedhë funksionale me kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë. Ndryshimet që rrjedhin nga ndryshimi i kursit të këmbimit të valutave janë njohur në të ardhura ose shpenzime.

Aktivitet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj, të cilat shprehen me kosto historike, këmbehen me kursin e datës së veprimit, me përjashtim të kapitalit aksionar të paguar, i cili është emetuar dhe mbahet në USD sipas legjislacionit në Shqipëri, dhe në veçanti në përputhje me Ligjin nr. 8634, datë 6 korrik 2000, sipas marrëveshjes ndërmjet aksionerëve të Bankës dhe Republikës së Shqipërisë mbi privatizimin e Bankës.

Për më tepër, Rregullorja e Operacioneve të Bankës kërkon që kapitali i aksionar i paguar të mbrohet nga aktivitet në USD, dhe prandaj është i trajtuar si një zë monetar, me diferencën e rivlerësimit të kaluar në fitim/humbje së bashku me diferencën e rivlerësimit të aktivitet korrespondues në USD, të cilat kompensojnë njëra-tjetrën në një mënyrë të natyrshme.

(ii) Operacionet e huaja

Aktivitet dhe detyrimet janë të kthyera në Lek me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Të ardhurat dhe shpenzimet janë kthyer në Lek me kursin e datës së veprimit. Diferencat e kursit të këmbimit që lidhen me kthimin e operacioneve të huaja, janë njohur direkt në të ardhura të tjera përmbledhëse. Këto diferencat janë njohur në rezervën e rivlerësimit.

(iii) Përkthimi i pasqyrave financiare nga monedha funksionale në monedhën e prezantimit

Përkthimi i pasqyrave financiare nga monedha funksionale në monedhën e prezantimit është si më poshtë:

- aktivitet dhe detyrimet në datën e raportimit (duke përfshirë shifrat krahasuese) janë kthyer me kursin e mbylljes në datën e raportimit.
- të ardhurat dhe shpenzimet (duke përfshirë shifrat krahasuese) janë kthyer me kurset e datës së veprimeve.
- zërat e kapitalit, përveç fitimit neto, kapitalit të paguar dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse janë kthyer me kursin e mbylljes në datën e raportimit.
- kapitali aksionar i paguar është kthyer siç është përshkruar në paragrafin 3(b),(i) më sipër.
- të gjitha diferencat prej kursit të këmbimit janë njohur si një përbërës i vecantë i kapitalit në llogarinë e 'Rezervës së rivlerësimit'.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2011

(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(b) Monedha të huaja (vazhdim)

(iv) Veprimet "spot" në monedhë të huaj

Banka, gjatë veprimtarisë normale të biznesit ndërmerr veprime në monedhë të huaj "spot", për të cilat data e kryerjes është 1 ose 2 ditë pas datës së tregtimit. Këto veprime janë regjistruar në pasqyrat financiare në datën e kryerjes. Diferencat në monedhë të huaj njihen në fitim/humbje në datën e kryerjes.

(c) Interesi

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që skanton saktësisht pagesat dhe arkëtimet e pritshme në të ardhmen gjatë jetëgjatësisë së parashikuar të aktivitetit ose detyrimit financiar (ose një periudhë më e shkurtër, kur duhet) deri në vlerën kontabël të aktivitetit ose detyrimit financiar. Kur llogarit normën e interesit efektiv, Banka vlerëson flukset e ardhshme monetare duke marrë në konsideratë të gjitha kushtet kontraktuale të instrumentit financiar, por jo humbjet e ardhshme.

Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha komisionet dhe shumat e paguara apo të arkëtuara, që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit. Kostot e veprimeve përfshijnë kosto shtesë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen apo emetimin e një aktivi apo detyrimi financiar.

(d) Tarifa dhe komisione

Të ardhurat dhe shpenzimet nga tarifat dhe komisionet, të cilat janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit për një aktiv ose detyrim financiar, përfshihen në matjen e normës efektive të interesit.

Të ardhurat e tjera nga komisionet dhe tarifat njihen në momentin e kryerjes së shërbimeve të lidhura me to.

Shpenzime të tjera për komisione dhe tarifa lidhen kryesisht me tarifa veprimesh ose shërbimesh, të cilat shpenzohen në momentin që shërbimet përfitohen.

(e) Pagesat e qirasë

Pagesat e kryera për qiranë operative janë njohur në fitim ose humbje në mënyre lineare gjatë periudhës së qirasë. Zbritjet nxitëse njihen si pjesë përbërëse e shpenzimit total të qirasë përgjatë jetës së qirasë.

Detyrimet e kushtëzuara për pagesat e qirasë llogariten duke rishikuar pagesat e ardhshme minimale përgjatë jetës së mbetur të qirasë, kur konfirmohen ndryshime të qirasë.

(f) Tatim fitimi

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në fitim ose humbje, përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital ose të ardhura të tjera përmbledhëse. Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet ose të arkëtohet mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që hyn në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë është njohur për diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe shumave të përdorura për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë nuk njihet për diferencat e mëposhtme: njohjen fillestare të emrit të mirë, njohjen fillestare të aktiveve apo detyrimeve në një veprim që nuk është kombinim biznesi dhe që nuk ndikon as fitim/humbjen kontabël dhe as atë të tatueshme, dhe diferenca lidhur me investimet në filiale në masën që ato mund të mos i kthejnë këto në të ardhmen. Tatimi i shtyrë është matur duke përdorur normën tatimore që pritet të aplikohet ndaj diferencave të përkohshme kur ato të kthehen, bazuar në ligjet në fuqi ose që hyjnë në fuqi në datën e raportimit.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2011

(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(f) Tatim fitimi (vazhdim)

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për aq sa është e mundur që do të realizohet fitim i ardhshëm i tatueshëm, në mënyrë që të mund të përdoret kundrejt tij. Aktiviteti i shtyrë rishikohet në çdo datë raportimi dhe zvogëlohet nëse nuk është e mundur të realizohet përfitim fiskal. Të ardhura të tjera të tatueshme nga shpërndarja e dividendëve, njihen në të njëjtën kohë kur njihet edhe detyrimi për të paguar dividendin.

(g) Aktivitet dhe detyrimet financiare

(i) Njohja

Banka fillimisht njihet huatë, depozitat, letrat me vlerë të borxhit të emetuar dhe detyrimet e varura në datën kur ato krijohen. Blerjet dhe shitjet normale të një aktivi financiar janë njohur në datën e tregtimit, në të cilën Banka zotohet të blejë ose të shesë aktivin. Të gjitha aktivitetet dhe detyrimet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregtimit, në të cilën Banka bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Një aktiv ose detyrim financiar është matur fillimisht me vlerën e drejtë plus (për një zë jo të matur më pas me vlerë të drejtë përmes fitim/humbjes) kostot e veprimit që janë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen apo emetimin e tij.

(ii) Klasifikimi

Referoju politikave kontabël 3(h), (i) dhe (j).

(iii) Mosnjohja

Banka nuk njihet një aktiv financiar, kur të drejtat kontraktuale ndaj flukseve monetare që rrjedhin nga aktivi financiar mbarojnë, ose kur ajo transferon të drejtat për të marrë flukseve monetare të aktivitetit financiar në një transaksion ku transferohen të gjitha rreziqet dhe përfitimet nga pronësia e aktivitetit financiar. Çdo interes mbi aktivitetet financiare të transferuara, i cili është krijuar apo përfituar nga Banka njihet si një aktiv ose detyrim i veçantë. Banka nuk njihet një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale përfundojnë, anulohen ose i mbaron afati.

Banka merr pjesë në veprime, me anë të të cilave transferon aktive të njohura në pasqyrën e pozicionit financiar, por në të njëjtën kohë ruan kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivitetit të transferuar ose një pjesë të tyre. Nëse ruhen të gjitha rreziqet dhe përfitimet apo pjesa me e madhe e tyre, atëherë aktivitetet e transferuara vazhdojnë të njihen në pasqyrën e pozicionit financiar. Transferimi i aktiveve ku ruhen thuajse të gjitha rreziqet dhe përfitimet, përfshin për shembull huadhënien e letrave me vlerë dhe veprimet e riblerjeve.

Kur aktivitetet i shiten një pale të tretë me një normë totale kthimi konvergjuese në kembim të aktiveve, veprimi konsiderohet si një transaksion financiar i siguruar, i ngjashëm me veprimet e riblerjes.

Banka cregjistron aktivin kur ajo nuk ka kontroll mbi të, pas veprimeve ku Banka as nuk ruan dhe as nuk transferon thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë mbi aktivin financiar. Të drejtat dhe detyrimet që mbahen pas transferimit njihen veçantë si aktiv apo detyrim, sipas rastit. Në transferat ku ruhet kontrolli mbi aktivin, Banka vazhdon të njohë aktivin, në masën e përfshirjes së saj në vazhdimësi, që përcaktohet nga masa në të cilën ajo është e ekspozuar ndaj ndryshimit të vlerës së aktivitetit të transferuar.

Në disa veprime Banka ka detyrimin për të shërbyer aktivitetit financiar të transferuar kundrejt një tarife. Aktiviteti i transferuar përfundon së njohuri tërësisht kur plotësohen kriteret e mosnjohjes. Një aktiv apo detyrim përfundon së njohuri për kontratën e shërbimit, varur nga fakti nëse tarifa e shërbimit është më se e përshtatshme (aktiv) ose është më pak se e përshtatshme (detyrim) për kryerjen e shërbimeve.

Banka bën fshirjen e kredive dhe investimeve kur përcaktohet se ato janë të paarkëtueshme.

3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(g) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(iv) Netimi

Aktivitetet financiare netohen me detyrimet financiare dhe vlera e tyre neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar, atëherë dhe vetëm atëherë kur Banka ka një të drejtë ligjore për të netuar shumat dhe ajo synon ose të shlyejë mbi një bazë neto, ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht. Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten mbi baza neto vetëm kur lejohet nga standartet e kontabilitetit, ose për fitime dhe humbje të lindura nga një grup veprimesh të ngjashme si në rastin e aktiviteteve tregtare të Bankës.

(v) Matja e kostos së amortizuar

Kostoja e amortizuar e një aktivi ose detyrimi financiar është vlera me të cilën aktivi ose detyrimi financiar matet në momentin fillestar, duke i zbritur pagesat e këstit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv të çdo diference ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturim, minus çdo zbritje për efekt zhvlerësimi.

(vi) Matja e vlerës së drejtë

Vlera e drejtë është shuma me të cilën një aktiv mund të shkëmbehet, ose një detyrim mund të shlyhet, midis palëve të mirëinformuara dhe me vullnet të plotë në kushte të lira tregu në datën e matjes.

Banka e llogarit vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmime të kuotuar në një treg aktiv për atë instrument, në rast se këto janë të disponueshme. Një treg quhet aktiv në qoftë se çmimet e kuotuar janë rregullisht të gatshme dhe paraqesin veprimet aktuale të vazhdueshme në kushte të lira tregu.

Në qoftë se nuk ka treg aktiv për një instrument financiar, Banka vendos vlerën e drejtë duke përdorur një teknikë vlerësimi. Teknikat e vlerësimit përfshijnë përdorimin e veprimeve më të fundit të kryera midis palëve të vullnetshme, të mirë informuara (nëse ka të tilla), krahasime me vlerën e drejtë për instrumente të tjerë të ngjashëm, analizat e fluksit monetar të skontuar, modelet e vendosjes së çmimit për opsionet. Teknika e vlerësimit e zgjedhur përdor maksimumin e inputeve të tregut dhe mbështetet sa më pak të jetë e mundur në inputet specifike të Bankës. Ajo përfshin të gjithë faktorët që pjesëmarrësit e tregut do të merrnin parasysh në caktimin e çmimit dhe është në përputhje me metodologjitë e pranura ekonomike për vlerësimin e instrumenteve financiarë. Inputet për teknikat e vlerësimit pasqyrojnë në mënyrë të arsyeshme pritshmërinë e tregut dhe matjet e faktorëve të rrezikut të kthimit, të qenësishëm në instrumentin financiar. Banka rishikon teknikën e vlerësimit dhe e teston atë për vlefshmëri, duke përdorur çmime nga veprime aktuale të mbikëqyrura lidhur me të njëjtin instrument, ose bazuar në të dhënat e disponueshme e të mbikëqyrura në treg.

Evidenca më e mirë e vlerës së drejtë të një instrumenti financiar në njohjen fillestare është çmimi i veprimit, p.sh. vlera e drejtë e shumës së dhënë ose të marrë, me përjashtim të rasteve kur vlera e drejtë e këtij instrumenti gjendet duke bërë krahasime me veprime të tjera, të vëzhguara në treg për të njëjtin instrument (pa modifikim apo rrimërtim), ose bazohet në një teknikë vlerësimi, variablat e të cilës përfshijnë vetëm të dhëna nga tregje të vëzhguara. Kur çmimi i veprimit ofron evidencën më të mirë për vlerën e drejtë për njohjen fillestare, instrumenti financiar matet fillimisht me çmimin e veprimit dhe ndonjë diferencë midis këtij çmimi dhe vlerës së përfutur fillimisht nga një model vlerësimi, njihet në vijim në fitim ose humbje gjatë jetës së instrumentit, varësisht nga faktet e rrethanat individuale të veprimit, por jo më vonë se atëherë kur vlerësimi mund të mbështetet plotësisht nga të dhëna të vëzhguara në treg, ose kur veprimi mbyllet.

(vii) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit

Në çdo datë raportimi Banka vlerëson nëse ka evidencë objektive që aktivet financiare të cilat nuk mbahen me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes, janë zhvlerësuar. Aktivet financiare zhvlerësohen nëse evidenca objektive tregon se një ngjarje zhvlerësimi ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit, dhe që ngjarja e zhvlerësimit ka një ndikim në flukset e ardhshme të mjeteve monetare të aktivitetit, të cilat mund të maten me besueshmëri.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2011

(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(g) Aktivët dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(vii) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit (vazhdim)

Treguesit objektivë që aktivet financiare janë të zhvlerësuar mund të përfshijnë mospagesa ose vështirësi financiare të huamarrësit, ristrukturimin e një huaje me kushte dhe afate të cilat Banka nuk do t'i kishte dhënë ndryshe, të dhëna që një huamarrës ose emetues i letrave me vlerë po falimenton, zhdukja e një tregu aktiv për një investim, ose të dhëna të tjera të dukshme lidhur me një grup aktivesh si p.sh ndryshime të pafavorshme në aftësinë paguese të një huamarrësi ose emetuesi të letrave me vlerë, ose kushte ekonomike që lidhen me paaftësi për të paguar Bankën. Për më tepër, rënia e konsiderueshme apo e shtrirë në kohë e vlerës së drejtë kundrejt kostos së investimeve për letrat me vlerë të kapitalit është një tregues objektiv zhvlerësimi.

Banka konsideron treguesit e zhvlerësimit për huatë dhe paradhëniet dhe investime të mbajtura deri në maturim si individualisht ashtu edhe në mënyrë kolektive. Të gjitha huatë e paradhëniet dhe investimet e mbajtura deri në maturim të cilat janë individualisht të rëndësishme, vlerësohen për zhvlerësim specifik. Për të gjitha huatë e paradhëniet dhe investimet e mbajtura deri në maturim të cilat janë individualisht të rëndësishme, të cilat nuk janë për t'u zhvlerësuar specifikisht, kryhet një rishikim për zhvlerësim në grup, që ka ndodhur, por nuk është identifikuar ende. Të gjitha huatë dhe investimet e mbajtura deri në maturim, të cilat nuk janë individualisht të rëndësishme, vlerësohen në mënyrë kolektive për zhvlerësim duke grupuar së bashku huatë e financimet dhe investimet e mbajtura deri në maturim që kanë karakteristika të ngjashme rreziku.

Humbja nga zhvlerësimi i një aktivi financiar të matur me koston e amortizuar është llogaritur si diferencë ndërmjet vlerës kontabël të aktivitetit dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme, të vlerësuar të skontuar me normën fillestare të interesit efektiv të aktivitetit financiar. Humbjet njihen në fitim ose humbje dhe pasqyrohen në një llogari provizioni përkundrejt huave. Interesat mbi aktivet e zhvlerësuar vazhdojnë të njihen nëpërmjet skontimeve të pandryshueshme. Kur një ngjarje pas datës së raportimit shkakton pakësim të zhvlerësimit, zvogëlimi i zhvlerësimit anulohet nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Humbja nga zhvlerësimi i letrave me vlerë të mbajtura për shitje njihet duke transferuar humbjen kumulative, e cila është njohur direkt në të ardhura të tjera përmbledhëse të fitim/humbjes. Humbja kumulative që është riklasifikuar nga të ardhura të tjera përmbledhëse në fitim/humbje është diferenca ndërmjet kostos së blerjes, së cilës i zbriten ripagimet e principalit dhe amortizimi, dhe vlera e drejtë aktuale së cilës i zbritet zhvlerësimi që është njohur më parë në fitim/humbje. Ndryshimet që i atribuohen vlerës së kohës, janë reflektuar si një komponent i të ardhurave nga interesi. Nëse, në një periudhë të ardhme, vlera e drejtë e një letre me vlerë të vlefshme për shitje të zhvlerësuar më parë rritet, dhe rritja lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes në fitim/humbje të humbjes nga zhvlerësimi, kjo humbje nga zhvlerësimi kthehet mbrapsht me shumën e kthimit të njohur në fitim ose humbje.

(h) Mjete monetare dhe ekuivalente me to

Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to përfshijnë kartëmonedha dhe monedha në arkë, gjendje të pakushtëzuara në bankat qendrore dhe të tjera aktive financiare shume likuide, me maturitet origjinal tre muaj ose më pak, subjekt i një rreziku jo domethënës ndaj ndryshimeve në vlerën e tyre të drejtë, dhe përdoren nga Banka në administrimin e angazhimeve afatshkurtra. Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to mbahen në pasqyrën e pozicionit financiar me kosto të amortizuar.

(i) Derivatët e mbajtur për menaxhimin e riskut

Derivatët e mbajtur për menaxhimin e riskut përfshijnë të gjithë aktivet dhe detyrimet derivative, të cilat nuk klasifikohen në aktivet apo detyrimet e tregtueshme. Derivatët e mbajtur për qëllime të administrimit të riskut mbahen në pasqyrën e pozicionit financiar me vlerën e drejtë.

(j) Hua dhe paradhënie

Huatë dhe paradhëniet janë aktive financiare jo-derivative, me pagesa fikse ose të përcaktuara, të cilat nuk janë kuotuar në tregje aktive dhe Banka nuk ka për qëllim t'i shesë menjëherë apo në periudhën afatshkurtër.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2011

(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(j) Hua dhe paradhënie (vazhdim)

Kur Banka blen një aktiv financiar dhe njëherësh hyn në një marrëveshje për ta rishitur këtë aktiv (apo aktiv shumë të ngjashëm me të) me një çmim të fiksuar në një datë të ardhshme ("marrëveshje të anasjella të riblerjes"), marrëveshja kontabilizohet si një hua apo paradhënie dhe aktivet në bazë të marrëveshjes nuk paraqiten në pasqyrat financiare të Bankës.

Huatë dhe paradhëniet fillimisht maten me vlerën e drejtë plus kosto të tjera direkte të veprimit, dhe në vijim maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, përveç rastit kur Banka zgjedh të mbajë huatë dhe paradhëniet me vlerën e drejtë nëpërmjet fitim/humbjes siç përshkruhet në politikat kontabël 3(g),(vi).

(k) Investime

Investimet njihen fillimisht me vlerë të drejtë, dhe në rastin e investimeve jo me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, plus koston shtesë të veprimit direkt, dhe më pas regjistrohen në varësi të klasifikimit si të mbajtura deri në maturim, ose të vlefshme për shitje.

(i) Investime të mbajtura deri në maturim

Investimet që mbahen deri në maturim janë aktive financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktuara dhe maturitet të përcaktuar, të cilat Banka ka synimin e qartë dhe aftësinë t'i mbajë deri në maturim, dhe të cilat nuk janë përcaktuar si me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes ose si të vlefshme për shitje.

Investimet që mbahen deri në maturim mbahen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Në rastet e shitjes ose riklasifikimit, përpara maturimit të një sasive më shumë se sa të rëndësishme të investimeve që mbahen deri në maturim, do të sillte riklasifikimin e të gjithë investimeve që mbahen deri në maturim si të vlefshme për shitje, dhe kjo do ta pengonte Bankën të klasifikonte investimet si të mbajtura deri në maturim, gjatë periudhës aktuale dhe gjatë dy viteve financiare pasues.

(ii) Investime të vlefshme për shitje

Investime e mbajtura për tregtim janë instrumente jo-derivative të cilat janë klasifikuar si të mbajtura për shitje ose nuk janë klasifikuar si ndonjë kategori tjetër e aktiveve financiare. Investimet e mbajtura për tregtim mbahen me vlerën e drejtë.

Të ardhurat nga interesi njihen në fitim/humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv. Fitimi ose humbja nga kursi i këmbimit për investime në letra me vlerë të mbajtura për shitje njihet në fitim/humbje. Ndryshime të tjera në vlerën e drejtë njihen direkt në të ardhura të tjera përmbledhëse deri në momentin kur investimi shitet ose zhvlerësohet, moment kur humbjet ose fitimet kumulative të njohura më parë në të ardhura të tjera përmbledhëse, njihen në fitim ose humbje.

(l) Aktive të qëndrueshme të trupëzuara

(i) Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara paraqiten me kosto, minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë. Kosto përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të lidhura me blerjen e aktivitetit.

Kur pjesë të një elementi të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara kanë jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si elemente të veçanta (komponentët kryesorë) të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara.

(ii) Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese a të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të elementit, nëse është e mundshme që Banka në të ardhmen të ketë përfitime ekonomike, që i atribuohen atij elementi, dhe nëse kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Vlera kontabël e pjesës së zëvendësuar cregjistrohet. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në fitim ose humbje në momentin kur ndodhin.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2011

(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(l) Aktive të qëndrueshme të trupëzuara (vazhdim)

(iii) Zhvlerësimi

Zhvlerësimi njihet në fitim ose humbje në mënyrë lineare përgjatë jetës së dobishme të çdo zëri të aktiveve afatgjata të trupëzuara. Toka nuk zhvlerësohet.

Vlerësimi për jetën e dobishme për periudhën aktuale dhe atë krahasuese është si më poshtë:

- | | |
|--|---------|
| • Ndërtesa dhe përmirësime të ambjenteve me qera | 20 vjet |
| • Mjete transporti dhe pajisje të tjera | 5 vjet |
| • Pajisje zyre | 5 vjet |
| • Kompjuterat dhe pajisje elektronike | 4 vjet |

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

(m) Aktivitet të qëndrueshme të patrupëzuara

Zërat e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara përfshijnë programet kompjuterike të blera nga Banka. Programet kompjuterike të blera nga Banka njihen me koston historike zvogëluar me amortizimin dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë.

Shpenzimet për zhvillimin e programeve kompjuterike nga vetë Banka njihen si aktive kur Banka është në gjendje të tregojë qëllimin dhe aftësinë për të plotësuar zhvillimin dhe përdorur programet kompjuterike në një mënyrë që do të gjenerojë përfitime ekonomike të ardhme, dhe mundet të masë me besueshmëri kostot e përfundimit të zhvillimit. Kapitalizimi i kostove të programeve të zhvilluara nga vetë Banka përfshin të gjithë kostot që i atribuohen direkt zhvillimit të programit kompjuterik dhe amortizohen me jetën e dobishme të tyre. Zhvillimi nga vetë Banka i programeve kompjuterike shprehet me koston e kapitalizuar duke i zbritur amortizimin e akumuluar dhe rënie në vlerë.

Shpenzime vijuese për programet kompjuterike kapitalizohen vetëm kur këto shpenzime ndikojnë në rritjen e përfitimit të ardhshëm ekonomik të aktivitetit të cilit i ngarkohen. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në periudhën kur ndodhin.

Amortizimi njihet në fitim ose humbje në mënyrë lineare përgjatë jetës së dobishme të programit kompjuterik duke filluar nga data në të cilën ky program është i gatshëm për përdorim. Jeta e dobishme e programeve kompjuterike është vlerësuar në katër vjet.

(n) Aktivitet e përfituara nga procesi ligjor

Aktivitet e përfituara nga procesi ligjor, janë përftuar përmes forcimit të sigurisë mbi të arkëtueshmet financiar, dhe kontabilizohen në varësi të klasifikimit të tyre si aktiv afatgjatë i mbajtur për shitje, apo si aktive afatgjata të investimit.

(i) Aktive afatgjata që mbahen për t'u shitur

Aktivitet afatgjata të mbajtura për t'u shitur pritet të rikuperohen kryesisht nëpërmjet shitjes dhe jo kundrejt përdorimit të vazhdueshëm. Menjëherë para klasifikimit si të mbajtura për t'u shitur, aktivitet rimaten sipas politikave kontabël të Bankës. Prej atij momenti, aktivitet maten me më të voglën mes vlerës kontabël dhe vlerës së drejtë minus kosto. Humbjet nga zhvlerësimi në klasifikimin fillestar dhe humbjet apo fitimi nga rimatja në vijimësi, njihen në fitim/humbje. Fitimet njihen deri në masën që nuk tejkalojnë ndonjë humbje kumulative nga rënia në vlerë.

(ii) Aktivitet afatgjata të investimit

Një aktiv afatgjatë i investimit është aktiv afatgjatë i mbajtur për të përftuar të ardhura nga qiraja, ose për fitime kapitale, ose për të dyja, por jo për përdorim në aktivitet ose furnizimin e të mirave apo shërbimeve, apo për qëllime administrative. Aktivitet afatgjata të investimit maten me vlerën e drejtë, referuar cmimeve të tregut, me çdo ndryshim të tyre, të njohur në fitim ose humbje. Kur përdorimi i një aktivitet afatgjatë ndryshon, aq sa ai riklasifikohet si prona dhe pajisje, vlera e drejtë e aktivitetit në datën e riklasifikimit bëhet kostoja e tij për kontabilizimin e mëtejshëm.

3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(o) Rënia e vlerës e aktiveve jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Bankës, përveç aktiveve tatimore të shtyra, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka tregues për rënie vlere. Nëse ka tregues të tillë, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit.

Humbja nga rënia në vlerë njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon vlerën e rikuperueshme. Njësia gjeneruese e mjeteve monetare është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron flukse monetare që janë të pavarura nga aktivet dhe grupet e tjera. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Humbjet nga zhvlerësimi të matura për njësi gjeneruese të mjeteve monetare, fillimisht zvogëlojnë vlerën kontabël të ndonjë aktivi jo-material që është pjesë e njësisë dhe pastaj redukton vlerën kontabël të aktiveve të tjera në njësi (apo grup njësisish) me një shpërndarje proporcionale mes tyre.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është më e madhja ndërmjet vlerës në përdorim dhe vlerës së tij të drejtë minus kostot e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset monetare të vlerësuarara të ardhshme janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave, që reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivin. Humbjet nga zhvlerësimi të njohura në periudhat e mëparshme vlerësohen në çdo datë raportimi për evidencë nëse humbja është zvogëluar ose nuk ekziston më.

Një humbje për zhvlerësim anulohet nëse ka patur ndryshim në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga zhvlerësimi anulohet deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivitetit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur zhvlerësimin ose amortizimin, sikur të mos ishte njohur ndonjë humbje nga rënia e vlerës.

(p) Depozitat

Depozitat janë pjesë e burimeve të financimit të Bankës. Kur Banka shet një aktiv financiar dhe njëkohësisht hyn në një marrëveshje për të riblerë këtë aktiv (ose një aktiv të ngjashëm) me një çmim fiks në të ardhmen ("repo" ose "huadhenie aksioni"), marrëveshja kontabilizohet si një depozitë, dhe aktivi vazhdon të njihet në pasqyrat financiare të Bankës.

Depozitat maten fillimisht me vlerën e drejtë plus kosto të tjera direkte të veprimit, dhe në vijim maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, përveç rastit kur Banka zgjedh të mbajë detyrimin me vlerën e drejtë nëpërmjet fitim/humbjes.

(q) Provigjonet

Një provigjon njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve të shkuara, Banka ka një detyrim ligjor ose konstruktiv të tanishëm i cili mund të matet në mënyrë të besueshme, dhe ka mundësi që për të shlyer detyrimin, të kërkohet një dalje e të mirave ekonomike. Provigjonet janë përcaktuar duke skontuar flukset e pritshme monetare me një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe, sipas rastit, rreziqet specifike të detyrimit.

Një provizion për ristrukturimin njihet kur Banka ka aprovuar një plan ristrukturimi të detajuar dhe formal dhe ristrukturimi ka filluar apo është publikuar. Kosto të ardhme operative nuk provigjonohen.

Një provigjon për kontratat pa fitim njihet kur përfitimet e pritshme për t'u marrë nga Banka për këto kontrata, janë më të vogla se kostot e pashmangshme për të plotësuar detyrimin sipas kontratës. Provigjoni matet me vlerën aktuale të më të voglës mes koston së pritshme të përfundimit të kontratës dhe koston neto të pritshme për të vazhduar me kontratën. Para se një provigjon të krijohet, Banka njej çdo humbje zhvlerësimi të aktiveve që lidhen me atë kontratë.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2011

(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(r) Përfitimet e punonjësve

(i) Plan pensioni me kontribute të përcaktuara

Detyrimet për kontributet ndaj planit të pensioneve me kontribut të përcaktuar njihen si shpenzim në fitim ose humbje kur ato ndodhin. Banka paguan kontributet e detyrueshme për sigurimet shoqërore që mbulojnë përfitimet e punonjësve pas dalin në pension. Autoritetet vendase janë përgjegjëse për dhënien e limitit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

(ii) Plani i përfitimit të pensionit

Banka ka krijuar një fond plan pensioni, plotësisht të financuar nga punëdhënësi i quajtur Programi i Mbështetjes së Stafit (shiko shënimin 21 "Fondi rezervë për punonjësit që dalin në pension") në vitin 2002. Shuma që regjistrohej tek ky fond ("PMS") vendosej në fillim të vitit në masën 5% të shpenzimeve vjetore të planifikuara për pagat e personelit. Gjatë vitit, shumën e përlogaritur regjistrohej në fitim ose humbje dhe tek fondi në bazë mujore.

Sipas planit të mësipërm, shumës së përlogaritur për punonjësit i shtohet interesi, i cili llogaritet që nga data kur punonjësit do të largoheshin dhe deri në daljen e tyre në pension. Kjo shumë do t'i paguhet punonjësve, vetëm kur ata të mbërrijnë moshën e pensionit, përcaktuar sipas ligjit shqiptar, në këste mujore të barabarta me minimumin e 75% e pensionit mujor shtetëror derisa fondi i akumuluar për punonjësit të konsumohet.

Bazuar në rezolutën e Këshillit Drejtues, në fuqi që nga 30 shtatori 2010, Banka ka ndaluar së investuari në këtë fond ("PMS"), duke e transformuar atë në Programin e Kredisë për Mbajtjen e Stafit ("PKMS"). Ndryshimet demografike në forcën punëmarrëse gjatë dhjetë viteve të fundit dhe moshën mesatare 31 vjeç e punonjësve, ku 80% e punonjësve janë nën moshën 40 vjeç, ka rezultuar se PMS nuk është tërheqëse për pjesën më të madhe të punonjësve të Bankës, pasi mund të gëzohet vetëm me daljen në pension. Në dallim nga ky plan, PKMS do të jetë më i dobishëm për të gjithë punonjësit e Bankës, sepse do të ofrojë kredi për shtëpi apo kredi konsumatore me terma preferencialë. Shuma e llogaritur për personat përfitues nga Programi i Mbështetjes së Stafit është ngrirë në të njëjtën datë. Shuma e ngrirë si pasojë e transformimit të programit të "PMS" në "PKMS" më 30 shtator 2010 dhe pjesa korresponduese e interesit vjetor, që do fitohet në të ardhmen deri në moshën e pensionit, dhe matet në bazë të normës së obligacioneve qeveritare AAA, regjistrohet si detyrime nga Banka.

(iii) Përfitimet afat-shkurtra

Detyrimet e përfitimeve afat-shkurtër të punonjësve maten në baza të paskontuara dhe janë shpenzuar sipas kryerjes së shërbimit lidhur me to.

Për shumën që pritet të paguhet sipas përfitimit monetar afat-shkurtër ose planeve të ndarjes së fitimeve, nëse Banka ka një detyrim aktual ligjor ose konstruktiv të paguajë këtë shumë si rezultat i shërbimeve të kaluara të kryera nga punonjësit dhe detyrimet mund të maten në mënyrë të besueshme, njihet provigjon.

(s) Raportimi i segmenteve

Një segment operues është një komponent i Bankës që është i përfshirë në aktivitete biznesi, nga të cilat mund të fitojë të ardhura dhe të kryejë shpenzime, duke përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me veprimet me komponentë të tjerë të Bankës, dhe rezultatet operative të të cilit, rishikohen në mënyrë të rregullt nga menaxhimi për të marrë vendime rreth ndarjes së burimeve të secilit segment dhe për të vlerësuar performancën e tyre, dhe për të cilin duhet informacion i veçantë i vlefshëm (shih notën 6). Forma e përdorur prej Bankës për raportim të segmentuar është bazuar në segmentimin gjeografik.

3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(t) Standarde dhe interpretime të reja ende të pa-adoptuara

Disa standarde të reja, ndryshime të standardeve ekzistuese dhe interpretime nuk janë ende ne fuqi më 31 dhjetor 2011, dhe nuk janë aplikuar në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara. Asnjë prej tyre nuk do të ketë efekt në pasqyrat financiare të Bankës, me përjashtim të:

- SNRF 9 *Instrumentat Financiarë* (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2015 ose më pas; për t'u aplikuar në të ardhmen). Ky standart zëvendëson udhëzimet e SNK 39, *Instrumentat Financiarë: Njohja dhe Matja*, në lidhje me klasifikimin dhe matjen e aktiveve financiare. Standardi eliminon kategoritë ekzistuese të SNK 39 për aktivet financiare të mbajtura deri në maturim, të vlefshme për shitje dhe huatë dhe llogaritë e arkëtueshme.

Aktivitet financiar do të klasifikohen në njërin prej dy kategorive në njohjen fillestare:

- aktive financiare të matura me kosto të amortizuar; ose
- aktive financiare të matura me vlerë të drejtë.

Një aktiv financiar matet me kosto të amortizuar nëse plotësohen dy kushtet e mëposhtme:

- aktivi mbahet brenda një modeli biznesi, objektivi i të cilit është që të mbajë aktivet për të mbledhur flukset monetare sipas termave kontraktuale; dhe
- sipas termave kontraktuale do rrjedhin flukse monetare në data të përcaktuara, që janë vetëm pagesa të këstit dhe të interesit mbi principalin e mbetur.

Fitimet dhe humbjet nga rimatja e aktiveve financiare me vlerë të drejtë njihen në fitim ose humbje, përveç rastit të një instrumenti investimi në kapital që nuk mbahet për t'u tregtuar, për të cilin SNRF 9 parashikon që me njohjen fillestare të bëhet një zgjedhje e pandryshueshme, për të paraqitur të gjitha ndryshimet në vlerën e drejtë të investimit, në të ardhura të tjera përmbledhëse ('ATP'). Zgjedhja është e vlefshme për çdo aksion individualisht. Asnjë shumë e njohur në ATP nuk mund të riklasifikohet në fitim ose humbje në një datë të mëvonshme.

Pritet që aplikimi për herë të parë i Standardit të ri, do të ketë një ndikim të ndjeshëm në pasqyrat financiare, meqenëse klasifikimi dhe matja e aktiveve financiare të Bankës pritet të ndryshojë. Sidoqoftë, Banka do të përgatisë një analizë të ndikimit që kjo do të ketë në pasqyrat financiare dhe planifikon ta përfundojë këtë analizë përpara datës së aplikimit fillestar. Banka nuk e ka vendosur ende se kur do të fillojë aplikimin e Standardit të ri.

- Ndryshime të SNRF 9 dhe SNRF 7: Data efektive e detyrueshme dhe shënime shpjeguese tranzitore. Këto amendime ndryshojnë kërkesat për shënime shpjeguese dhe rivlerësime, që lidhen me aplikimin fillestar të SNRF 9 *Instrumentat Financiarë*. SNRF 7 e ndryshuar kërkon që të jepen më shumë shpjegime për detajet rreth efektit të aplikimit fillestar të SNRF 9 kur një shoqëri nuk rivlerëson informacionin krahasues sipas kërkesave të ndryshuara të SNRF 9.

Nëse një shoqëri aplikon SNRF 9 në ose pas 1 janarit 2013, atëherë nuk do të kërkohej rivlerësimi i informacionit krahasues për periudhat përpara datës së aplikimit fillestar. Nëse një shoqëri aplikon SNRF 9, në fillim të 2012, atëherë ka zgjedhjen ose të rivlerësojë informacionin krahasues, ose të sigurojë shpjegime të zgjeruara sic kërkohej nga SNRF 7. Nëse një shoqëri aplikon SNRF 9 përpara 2012, atëherë nuk kërkohej as rivlerësimi i informacionit krahasues as sigurimi i shpjegimeve të zgjeruara, sipas SNRF 7 të ndryshuar.

Pritet që ndryshimet, kur aplikohen fillimisht, do të kenë një ndikim në pasqyrat financiare, meqenëse klasifikimi dhe matja e aktiveve financiare të Bankës, pritet të ndryshojnë dhe efekti i tij do të kërkohej të shpjegohet në pasqyrat financiare të Bankës.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2011

(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

4. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Drejtimi diskuton me Komitetin e Auditimit mbi zhvillimin, zgjedhjen dhe shënimet shpjeguese të politikave dhe vlerësimeve kritike të Bankës, dhe aplikimin e këtyre politikave dhe vlerësimeve.

Këto shënime shpjeguese mbështesin komentet mbi administrimin e rrezikut financiar (shih shënimin 5).

Fonde për humbjet nga zhvlerësimi i kredive

Aktivitetet e regjistruara me kosto të amortizuara vlerësohen për zhvlerësim në bazë të politikave kontabël të përshkruara në 3(g)(vii).

Banka rishikon portofolin e kredive për të përcaktuar zhvlerësimin në baza mujore. Në përcaktimin nëse humbja nga zhvlerësimi duhet të regjistrohet në fitim/humbje, Banka bën gjykime nëse ka të dhëna që tregojnë se ka një rënie të konsiderueshme në flukset e vlerësuara monetare të ardhme nga portofoli i kredisë para se rënia të identifikohet me një kredi individuale në atë portofol. Kjo evidencë mund të përfshijë të dhëna të vëzhguara që tregojnë se kanë ndodhur ndryshime të padëshiruara në statusin e pagesave të kredive në një grup, ose kushte ekonomike kombëtare apo lokale që lidhen me mospagimin e aktiveve në grup. Drejtimi përdor gjykime bazuar në eksperiencën e humbjes historike për aktivitetet me karakteristika të rrezikut të kredisë dhe evidencën të zhvlerësimeve të ngjashme me ato të portofolit kur skedulohen flukset e ardhme të parasë. Metodologjia dhe supozimet e përdorura për vlerësimin e shumës dhe kohës së flukseve të ardhme të parasë janë rishikuar në mënyrë të rregullt për të reduktuar çdo diferencë ndërmjet humbjes së vlerësuar dhe humbjes aktuale.

Investimet e mbajtura deri në maturim

Banka ndjek udhëzimet e SNK 39 në klasifikimin e aktiveve financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktuara dhe maturitetet të përcaktuara, si të mbajtura deri në maturitet. Klasifikimi kërkon gjykime të rëndësishme. Në bërjen e këtij gjykimi, Banka vlerëson qëllimin dhe aftësinë e saj për të mbajtur investime të tilla deri në maturitet. Nëse Banka dështon të mbajë këto investime deri në maturitet, përveç rasteve të veçanta, për shembull shitja e një shume jo të konsiderueshme afër maturitetit, do të kërkohej që të klasifikohet e tërë kategoria, si e vlefshme për tu shitur. Investimet do të duhet të maten me vlerën e drejtë dhe jo me koston e amortizuar.

Përcaktimi i vlerës së drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë për aktivitetet dhe detyrimet financiare për të cilat nuk ka një çmim tregu të dukshëm kërkon përdorimin e teknikave të vlerësimit siç përshkruhen në politikën kontabël 3(g)(vi). Për instrumentet financiare që tregtohen rrallë dhe që nuk kanë transparencë në çmim, vlera e drejtë është më pak objektive dhe kërkon shkallë të ndryshme gjykimi bazuar në likuiditetin, përqendrimin, pasigurinë e faktorëve të tregut, supozime rreth çmimit dhe rreziqe të tjera që ndikojnë mbi instrumentin specifik. Referoju gjithashtu "Vlerësimi i instrumenteve financiarë " më poshtë.

Gjykimet kritike kontabël në zbatimin e politikave kontabël të Bankës

Gjykime kritike kontabël në zbatimin e politikave kontabël të Bankës përfshijnë:

Vlerësimi i instrumenteve financiarë

Politika kontabël e Bankës për matjen e vlerës së drejtë është trajtuar në shënimin 3(g)(vi).

Banka e mat vlerën e drejtë duke përdorur hierarkinë e mëposhtme të metodave:

- Niveli 1: Çmime të kuotuar në një treg aktiv për një instrument identik.
- Niveli 2: Teknika vlerësimi bazuar në inpute të vëzhgueshme. Kjo kategori përfshin instrumente të vlerësuara duke përdorur çmime të kuotuar në tregje aktive për instrumente të ngjashëm, çmime të kuotuar për instrumente të ngjashëm në tregje që konsiderohen më pak se aktivë; ose teknika të tjera vlerësimi ku të gjithë inputet e rëndësishme janë të vëzhgueshme në mënyrë direkte ose jo-direkte nga të dhënat e tregut.

4. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)

Vlerësimi i instrumenteve financiarë (vazhdim)

• Niveli 3: Teknika vlerësimi që përdorin inpute të rëndësishme të pavëzhgueshme. Kjo kategori përfshin të gjithë ato instrumente ku teknika e vlerësimit përfshin inpute që nuk bazohen në të dhëna të vëzhgueshme dhe inputet e pavëzhgueshme mund të kenë një efekt të rëndësishëm në vlerësimin e instrumentit. Kjo kategori përfshin instrumente që janë vlerësuar bazuar në çmime të kuotuar për instrumente të ngjashëm ku kërkohen rregullime apo gjykime të rëndësishme e të pavëzhgueshme për të reflektuar ndryshimin midis instrumenteve.

Vlera e drejtë për aktivet dhe detyrimet financiare që tregtohen në tregje aktivë bazohen në çmime tregu të kuotuar apo kuotime te agjentëve. Për të gjitha instrumentet e tjerë financiarë Banka përcakton vlerën e drejtë duke përdorur teknika vlerësimi. Teknikat e vlerësimit përfshijnë vlerën aktuale neto dhe modele të skontimit të flukseve monetare, krahasime me instrumente të ngjashëm për të cilët ekzistojnë çmime të dukshme tregu dhe modele të tjera vlerësimi. Objektivi i teknikave të vlerësimit është të arrijnë në përcaktimin e vlerës së drejtë që reflekton çmimin e instrumentit financiar në datën e raportimit, i cili do të ishte përcaktuar nga pjesëmarrës në treg që veprojnë me kushtet e tregut

Banka përdor modele vlerësimi të njohura gjerësisht për përcaktimin e vlerës së drejtë të instrumenteve financiarë më të thjeshtë dhe më të zakonshëm, si norma interesi dhe këmbime monedhash që përdorin vetëm të dhëna tregu të vëzhgueshme dhe kërkojnë pak gjykim apo vlerësim nga drejtuesit. Çmimet e dhe inputet model të vëzhgueshme janë zakonisht të vlefshme në treg për instrumente kapitale dhe huaje të listuara në bursa, derivativë të tregtueshëm me këmbim, dhe derivativë të thjeshtë të tregtueshëm mbi banak si Swaps mbi e normat e interesit. Disponueshmëria e çmimeve të vëzhgueshme të tregut dhe e inputeve model redukton nevojën për gjykimin dhe vlerësimin e drejtuesve dhe redukton gjithashtu pasiguritë që shoqërojnë përcaktimin e vlerës së drejtë. Disponueshmëria e çmimeve të vëzhgueshme të tregut dhe inputeve varion ne varësi të produkteve dhe tregjeve dhe është e prirur ndaj ndryshimeve bazuar në ngjarjet specifike dhe kushtet e përgjithshme në tregjet financiare.

Për instrumente financiare më komplekse, Banka përdor modele vlerësimi të veçanta, të cilat janë zakonisht të zhvilluara bazuar ne modele të njohura vlerësimi. Disa ose të gjithë inputet e rëndësishme në këto modele mund të mos jenë të vëzhgueshme në treg dhe janë rrjedhojë e çmimeve të tregut ose kurseve ose janë vlerësuar e bazuar në gjykime. Modelet e vlerësimit që përmbajnë inpute të rëndësishme të pavëzhgueshme kërkojnë një shkallë më të lartë gjykimi dhe vlerësimi nga drejtuesit në përcaktimin e vlerës së drejtë. Gjykimi dhe vlerësimi i drejtuesve kërkohet zakonisht për zgjedhjen e modelit të vlerësimit për t'u përdorur, përcaktimin e flukseve monetare të pritshme për instrumentin financiar që vlerësohet, përcaktimin e probabilitetit për mospagesën apo parapagimet nga pala tjetër dhe përzgjedhjen e normave të përshtatshme për skontim.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.**Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2011**

(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

4. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimëve (vazhdim)**Vlera e drejtë**

Tabela më poshtë paraqet vlerën kontabël dhe vlerën e drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare dhe analizon instrumentet financiare, të matura me vlerën e drejtë në fund të periudhës raportuese, sipas nivelit të hierarkisë së vlerës së drejtë, në të cilën është kategorizuar matja e vlerës së drejtë:

	Shënime	Vlera kontabël			Totali
		Vlera kontabël	Niveli 1	Niveli 2	
31 dhjetor 2011					
Depozita dhe llogari me bankat	8	114,409,670	-	114,409,670	
Bono thesari	9	209,153,101	-	209,210,240	
Investime të vlefshme për shitje	10	143,171,647	71,203,748	143,171,647	
Investime të mbajtura deri në maturim	11	288,885,306	-	287,228,190	
Hua dhe paradhënie për bankat	12	98,888,938	-	98,888,938	
Hua dhe paradhënie për klientët	13	778,063,334	-	778,063,334	
Totali i aktiveve financiare		1,632,571,996	71,203,748	1,559,768,271	
Detyrime ndaj klientëve	17	1,581,303,036	-	1,581,303,036	
Detyrime ndaj bankave e institucioneve financiare	18	130,867,465	-	130,867,465	
Totali i detyrimeve financiare		1,712,170,501	-	1,712,170,501	
31 dhjetor 2010					
Vlera kontabël					
	Shënime	Vlera kontabël	Niveli 1	Niveli 2	Totali
Depozita dhe llogari me bankat	8	113,703,073	-	113,703,073	113,703,073
Bono thesari	9	187,826,686	-	188,104,036	188,104,036
Investime të vlefshme për shitje	10	101,714,745	85,936,698	15,778,047	101,714,745
Investime të mbajtura deri në maturim	11	275,915,418	-	277,321,670	277,321,670
Hua dhe paradhënie për bankat	12	68,810,445	-	68,810,445	68,810,445
Hua dhe paradhënie për klientët	13	551,045,870	-	551,045,870	551,045,870
Totali i aktiveve financiare		1,299,016,237	85,936,698	1,214,763,141	1,300,699,839
Detyrime ndaj klientëve	17	1,309,651,520	-	1,309,651,520	1,309,651,520
Detyrime ndaj bankave e institucioneve financiare	18	62,398,988	-	62,398,988	62,398,988
Totali i detyrimeve financiare		1,372,050,508	-	1,372,050,508	1,372,050,508

Vlera e drejtë e kontratave të kursit të këmbimit i afrohet vlerës kontabël të tyre, sic paraqitet në shënimet 16 dhe 21.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2011

(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

5. Administrimi i rrezikut financiar

(a) Hyrje e përgjithshme

Banka është e ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiare:

- rreziku i kredisë
- rreziku i likuiditetit
- rreziqet e tregut
- rreziku operacional

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Bankës ndaj secilit prej rreziqeve të mësipërme, objektivat, politikat dhe proceset e Bankës për matjen dhe administrimin e rrezikut, dhe administrimin e kapitalit të Bankës.

Një instrument financiar është çdo kontratë që jep mundësinë për të marrë mjete monetare ose aktive të tjera financiare nga një palë tjetër (aktiv financiar) ose detyrimin për të dhënë mjete monetare ose ndonjë aktiv tjetër financiar ndonjë palë tjetër (detyrim financiar).

Instrumentet financiare rezultojnë me rrezik për Bankën. Rreziqet kryesore me të cilët përballet Banka janë rreziku i kredisë, rreziku i likuiditetit dhe ai i tregut. Rreziku i tregut përfshin rrezikun në monedhë të huaj, rrezikun e normës së interesit dhe rreziqe të tjera çmimi.

Struktura e administrimit të rrezikut

Këshilli Drejtues ka përgjegjësinë e përgjithshme për themelimin dhe vëzhgimin e strukturës së administrimit të rrezikut në Bankë. Këshilli ka themeluar Komitetin e Administrimit të Aktiveve dhe Pasiveve (ALCO) dhe Komitetet e Rrezikut të Kredisë, të cilët janë përgjegjës për zhvillimin dhe monitorimin e politikave të administrimit të rrezikut në pjesët e tyre përkatëse. Të gjithë këta, i raportojnë në mënyrë të rregullt Këshillit Drejtues për aktivitetet e tyre.

Politikat e menaxhimit të rrezikut janë vendosur me qëllimin për të identifikuar dhe analizuar rreziqet që përballet Banka, për të vendosur limitet dhe kontrollet e përshtatshme, dhe për të monitoruar rreziqet dhe zbatimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e menaxhimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut, produktet dhe shërbimet e ofruara. Banka, përmes trajnimeve dhe standardeve e procedurave të menaxhimit, synon të zhvillojë një ambient kontrolli konstruktiv dhe të disiplinuar në të cilin gjithë punonjësit i kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre.

Komiteti i Auditimit të Bankës është përgjegjës për monitorimin e përputhshmërisë së politikave dhe procedurave për menaxhimin e rrezikut të Bankës, dhe për rishikimin e përshtatshmërisë së strukturës së administrimit të rrezikut në lidhje me rrezikun me të cilin përballet Banka. Komiteti i Auditimit të Bankës ndihmohet në këtë funksion edhe nga Auditimi i Brendshëm. Auditimi i Brendshëm bën rishikime si të rregullta ashtu edhe rishikime ad-hoc të kontrolleve për administrimin e rrezikut dhe procedurave, rezultate të cilat raportohen në Komitetin e Auditimit.

(b) Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes financiare të Bankës nëse një klient apo pala tjetër e një instrumenti financiar dështon në përmbushjen e detyrimeve kontraktuale, dhe rrjedh kryesisht nga huatë dhe paradhëniet ndaj klientëve dhe bankave të tjera dhe nga investimet. Për qëllime të raportimit të administrimit të rrezikut, Banka konsideron të gjithë elementët e ekspozimit të rrezikut të kredisë (si rreziku i mospagimit të kredisë, rreziku i sektorit dhe vendit). Banka ka krijuar një komitet kredie për të mbikëqyrur aprovimin e kërkesave të kredive. Kërkesat e kredive me shuma më të mëdha se 1,000,000 Euro aprovohen vetëm me vendimin e Këshillit Drejtues të Bankës. Ka një fokusim të vazhdueshëm për cilësinë e kredive në momentin e aprovimit dhe gjatë jetës së tyre.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2011

(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

5. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Çdo njësi kërkohet të jetë në përputhje me politikat dhe procedurat e kredisë së Bankës. Auditime të rregullta të njësive të biznesit dhe Departamentit të Administrimit të Rrezikut të Kredisë ndërmerren nga Auditimi i brendshëm.

Ekspozimi maksimal i rrezikut të kredisë

Ekspozimi maksimal i Rrezikut të kredisë para kolateralit dhe ndonjë rritjeje tjetër të kredisë me 31 dhjetor 2011 dhe 2010 paraqitet më poshtë:

	31 dhjetor 2011	31 dhjetor 2010
Bono thesari dhe bono të tjera të vlefshme	209,153,101	187,826,686
Të arkëtueshme nga bankat e tjera	213,298,608	182,513,518
Hua dhe paradhënie neto për klientët	778,063,334	551,045,870
Investime të vlefshme për shitje	143,171,647	101,714,745
Investime të mbajtura deri në maturim	288,885,306	275,915,418
Garanci financiare	58,924,699	21,083,914
Letra krediti në pritje	3,536,807	6,992,020
Angazhime për të dhënë kredi	39,460,685	30,704,665
Ekspozimi maksimal i rrezikut të kredisë	1,734,494,187	1,357,796,836

Hua dhe letra me vlerë të zhvlerësuar

Hua dhe letra me vlerë të zhvlerësuar janë ato hua dhe letra me vlerë për të cilat Banka ka përcaktuar se është e mundur që ajo nuk do jetë në gjendje të arkëtojë të gjithë shumën e interesit dhe të principalit në bazë të kushteve të kontratës. Këto kredi cilësohen si A deri në D, sipas sistemit të brendshëm të Bankës për cilësimin e rrezikut të kredisë. Komiteti i Rrezikut të BKT është i angazhuar me cilësimin e klientëve dhe me kategorinë e tyre përkatëse. Ai vendos mbi ndryshimet në cilësim dhe ndërmer veprimet e nevojshme sipas procedurave të monitorimit. Komiteti i Rrezikut cilëson çdo kredi sipas këtyre faktorëve:

- Aftësia për të paguar
- Kushtet financiare
- Aftësia e drejtimit
- Kolaterali dhe Garantuesit
- Struktura e kredive
- Industria dhe ekonomia

Nga viti 2010, Banka ka zhvilluar "Metodologjinë e Vlerësimit të Kredive Tregtare dhe të Korporatave" sipas kërkesave të BASEL II dhe ka vendosur 9 vlerësime (nga AAA në C), me analiza cilësore dhe sasore, raporte financiare dhe analiza të tendencës për dy vite të njëpasnjëshëm për të ruajtur dhe përmirësuar analizën e riskut. Këto vlerësime do të aplikohen për të gjithë analizat e kredisë, vit pas viti dhe grupe të kredive të vlerësuar do krijohen. Sidoqoftë, vlerësimi, tendenca dhe tranzicioni i tij, që do të krijojë një gjykim dhe marrje më të mirë vendimesh, nuk është finalizuar ende.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2011

(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

5. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Hua të vonuara por të pa-zhvlrësuara

Huatë dhe investimet e vonuara por të pa-zhvlrësuara janë ato për të cilat pagesat e interesit ose të principalit sipas kontratës, janë me vonesë por që Banka beson se zhvlrësimi nuk është i përshtatshëm për shkak të garancisë/kolateralit të vlefshëm dhe/ose shkallës së arkëtimit të shumës që i detyrohen Bankës.

Hua me kushte të ndryshuara

Hua me kushte të ndryshuara janë hua të cilat janë ristrukturuar për shkak të përkeqësimit të situatës financiare të klientit dhe kur Banka ka bërë lëshime të cilat nuk do t'i bënte në rast të kundërt.

Pasi huaja është ristrukturuar, ajo qëndron në të njëjtën kategori, edhe pse performanca pas ristrukturimit mund të përmirësohet.

Fondi për zhvlrësim

Banka vendos një fond për humbjet nga rëniet në vlerë, i cili përfaqëson vlerësimin e humbjeve të ndodhura në portofolin e kredive. Kjo lidhet me komponentin e humbjes specifike për ekspozimet e rëndësishme individuale. Referojuni shënimit 4.

Politika e fshirjes nga librat

Banka fshin një hua ose investim (dhe ndonjë fond për humbjet nga zhvlrësimi prej tyre), me vendimin e Komitetit të Kredisë së Bankës, në përputhje me rregulloren e bankës së Shqipërisë "Mbi administrimin e rrezikut të kredisë". Vendimi i fshirjes merret pasi është marrë në konsideratë ndodhja e ndryshimeve në pozicionin financiar të huamarrësit, e tillë që con në paaftësi të huamarrësit për të paguar detyrimin, ose hyrjet nga kolaterali nuk janë të mjaftueshme për të paguar ekspozimin e mbetur.

31 dhjetor 2011	Hua dhe paradhënie për klientët			
	Individe	Korporata	Paradhënie	Totali
Pa ditë-vonesa dhe zhvlrësim	165,438,301	453,215,767	2,133,045	620,787,113
Me ditë-vonesa dhe të testuara individualisht, por jo të zhvlrësuara	47,683,427	104,507,559	47,918	152,238,904
Të zhvlrësuara në mënyrë individuale	9,099,522	8,395,490	2,692,711	20,187,723
Totali i kredive, bruto (Shënimi 13)	222,221,250	566,118,816	4,873,674	793,213,740
Fondi i zhvlrësimit	(5,696,566)	(6,819,056)	(2,634,784)	(15,150,406)
Total i kredive, minus zhvlrësimin	216,524,684	559,299,760	2,238,890	778,063,334

31 dhjetor 2010	Hua dhe paradhënie për klientët			
	Individe	Korporata	Paradhënie	Totali
Pa ditë-vonesa dhe zhvlrësim	136,272,166	292,172,343	3,403,722	431,848,231
Me ditë-vonesa dhe të testuara individualisht, por jo të zhvlrësuara	34,583,520	78,076,301	17,347	112,677,168
Të zhvlrësuara në mënyrë individuale	9,433,726	6,220,194	2,572,915	18,226,835
Totali i kredive, bruto (Shënimi 13)	180,289,412	376,468,838	5,993,984	562,752,234
Fondi i zhvlrësimit	(4,553,231)	(4,629,714)	(2,523,419)	(11,706,364)
Total i kredive, minus zhvlrësimin	175,736,181	371,839,124	3,470,565	551,045,870

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.**Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2011**

(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

5. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)**(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)**

E paraqitur më poshtë është një analizë sipas cilësisë së kredisë për kreditë e korporatave:

Vlerësimi	31 dhjetor 2011	31 dhjetor 2010
A – Mirë	33,373,509	3,849,357
B – Pranueshëm	427,194,317	293,494,511
C – Nën monitorim	82,488,158	52,492,209
D – E papranueshme	19,269,617	21,642,890
(Shënimi 13)	562,325,601	371,478,967
Interesi i përllogaritur	5,815,772	6,125,362
Minus: të ardhurën e komisionit të shtyrë	(2,022,557)	(1,135,491)
Totali	566,118,816	376,468,838

Më poshtë paraqitet lista e huave dhe paradhënieve për klientët, ku vlera e tyre kontabël është rinegociuar dhe mbahen nën kontroll:

	Hua dhe paradhënie për klientët			Totali kredive
	Individë	Korporata	Paradhënie	
31 dhjetor 2011	1,622,719	23,312,407	136,418	25,071,544
31 dhjetor 2010	701,253	18,333,581	141,353	19,176,187

Më poshtë paraqitet analiza e ditë-vonesave si të zhvlerësuara ashtu edhe të pa-zhvlerësuara në mënyrë individuale:

31 dhjetor 2011	Hua dhe paradhënie për klientët			Total i kredive
	Individë	Korporata	Paradhënie	
Ditë-vonesa deri në 31 ditë	12,017,263	37,816,346	712,594	50,546,203
Ditë-vonesa 32-60 ditë	7,037,730	6,335,829	356,239	13,729,798
Ditë-vonesa 61-90 ditë	5,766,606	7,168,258	208,441	13,143,305
Ditë-vonesa 91-180 ditë	3,310,821	7,569,019	198,185	11,078,025
Ditë-vonesa 181 ditë - 365 ditë	3,824,761	3,398,118	111,005	7,333,884
Ditë-vonesa 1-2 vite	3,076,627	14,383,213	112,074	17,571,914
Ditë-vonesa mbi 2 vite	2,201,673	6,744,916	41,113	8,987,702
Totali	37,235,481	83,415,699	1,739,651	122,390,831

31 dhjetor 2010	Hua dhe paradhënie për klientët			Total i kredive
	Individë	Korporata	Paradhënie	
Ditë-vonesa deri në 31 ditë	11,130,329	21,001,353	389,247	32,520,929
Ditë-vonesa 32-60 ditë	3,372,554	4,035,210	296,679	7,704,443
Ditë-vonesa 61-90 ditë	3,719,625	3,756,951	320,984	7,797,560
Ditë-vonesa 91-180 ditë	3,196,617	24,278,483	196,380	27,671,480
Ditë-vonesa 181 ditë - 365 ditë	3,742,507	2,299,316	74,930	6,116,753
Ditë-vonesa 1-2 vite	2,406,835	3,951,799	83,526	6,442,160
Ditë-vonesa mbi 2 vite	1,287,893	6,346,600	24,542	7,659,035
